



This project is financed
by the European Union



NORWEGIAN
HELSINKI COMMITTEE



NETHERLANDS
HELSINKI
COMMITTEE



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Helsinki committee in the Balkans
prava a life



TOGETHER FOR LIFE

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM SFIDA MADHORE E KOHËS SONË

MANUAL PËR ORGANIZATAT
E SHOQËRISË CIVILE

2018



“Ky manual u realizua në kuadër të projektit “Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.”

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM SFIDA MADHORE E KOHËS SONË

MANUAL PËR ORGANIZATAT
E SHOQËRISË CIVILE

2018

Përgatitën manualin:

Znj. Izabela Kisic - Drejtore ekzekutive Komiteti Serb i Helsinkit për të drejtat e njeriut

Z. Dushko Radosavleviq - Ekspert nga Serbia

Znj. Jarmila Bujak Stanko - Eksperte nga Serbia

Z. Predrag Petroviq - Ekspert nga Serbia

Z. Pavle Kilibarda - Ekspert nga Serbia

Z. Pavel Domonji - Ekspert nga Serbia

Përgatitën për botim:

Klejda Ngjela - Menaxhere projektsh në KShH

Rovena Vuksani - Asistente projektsh në KShH

Supervizim:

Erida Skëndaj - Drejtore Ekzekutive e KShH

Redaktoi:

Hysni Ndreu

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Nëse jeni të interesuar për këtë manual, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati "Tekno Projekt" Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr. 1752

Tel: +355 4 2233671 Cel: +355 682023699

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinkit/>

e-mail: office@ahc.org.al;

www.ahc.org.al

PËRMBAJTA

LISTË AKRONIMESH.....	2
1. HYRJE.....	5
2. Ç'ËSHTË EKSTREMIZMI I DHUNSHËM?.....	7
3. RADIKALIZMI DHE TË RINJTË.....	8
3.1 Cilët janë faktorët e përgjithshëm që ndikojnë në radikalizëm?.....	8
3.2 Cilët janë faktorët e jashtëm?.....	10
3.3 Cilët janë faktorët e tjerë?.....	11
4. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT.....	12
4.1 Ç'është terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm sipas legjislacionit/standardeve ndërkombëtare?.....	14
4.2 Cilat janë traktatet e Kombeve të Bashkuara për terrorizmin?.....	15
4.3 Cili është kuadri ligjor shtesë i Kombeve të Bashkuara?.....	16
4.4 Cili është legjislacioni në Europë?.....	18
4.5 Si paraqitet terrorizmi në situatat e konfliktit të armatosur?.....	20
4.6 Si paraqitet terrorizmi në raport me të drejtat e njeriut?.....	21
5. SI ADRESOHET EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KUADRIN TONË LIGJOR KOMBËTAR (SHQIPËRIA)?.....	23
5.1 Përse është i nevojshëm një kuadër ligjor dhe institucional kundër ekstremizmit të dhunshëm?.....	23
5.2 Cilat janë konventat/marrëveshjet që ka ratifikuar vendi ynë?.....	23
5.3 Cilat janë veprat penale që dënojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?.....	24
5.4 Ku dallon vepra penale në fushën e terrorizmit nga veprat e tjera penale?.....	25
5.5 A dënohet penalisht pjesëmarrja e shtetasve shqiptarë në veprime luftarake jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë?.....	26
5.6 A parashikon masa të tjera shtesë legjislacioni ynë për të parandaluar dhe goditur financimin e terrorizmit?.....	27
5.7 A ka miratuar vendi ynë dokumente strategjike për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm?.....	28
6. SI DUHET TË NDËRVEPROJNË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR TË PARANDALUAR E ADRESUAR RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN?.....	30
6.1. Cilat janë modelet pozitive të ndërveprimit të shoqërisë civile? (Shembuj nga vendet fqinje – arritjet e programit në Sanxhak).....	33

7. PROCESI I RADIKALIZIMIT DHE SHENJAT PARALAJMËRUESE.....38

7.1 Si identifikohen individët që janë në rrezik për t'u radikalizuar?.....	38
7.2 Kush e nxit dhe e dikton radikalizmin (faktorët)?.....	39
7.3 Si evoluojnë etapat e radikalizimit tek individët?.....	40
7.4 Cilat janë shenjat e hershme paralajmëruese të radikalizimit dhe ekstremizmit?...	42

8. ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM...44

8.1 Cili duhet të jetë roli i organeve ligjzbatuese?	44
8.2 Cili është roli i OSHC-ve në raport me punën e institucioneve ligjzbatuese?.....	45
8.3 Sa i rëndësishëm është policimi në komunitet, si mjet i kthimit të besimit te policia?.....	45
8.4 Cili është roli i OSHC-ve lidhur me policimin në komunitet?.....	47
8.5 Ç'janë këshillat lokale të sigurisë dhe përse janë të nevojshëm?.....	47
8.6 Cili është roli i OSHC-ve në raport me këshillat lokale të sigurisë?.....	49
8.7 Ç'është mekanizmi referues dhe përse është i rëndësishëm?.....	49
8.8 Cili është roli i OSHC-ve në raport me mekanizmin referues?.....	50

LISTË AKRONIMESH

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

DNH - E drejta Ndërkombëtare Humanitare

DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

BE – Bashkimi Europian

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

BEDZ – Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi

KLS – Këshilli Lokal i Sigurisë

LKEDh - Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

KNKK - Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

LDNj - Legjislacioni për të Drejtat e Njeriut

1. HYRJE

Të dashur lexues,

Radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë shndërruar në një sfidë ndaj të gjitha shteteve e shoqërive, për shkak të përhapjes, dinamikës dhe prirjeve që kanë pasur vitet e fundit këto fenomene, si dhe për shkak të pasojave tepër të rrezikshme për jetën dhe sigurinë e njerëzve. Shkaqet e tyre janë nga më të ndryshmet. Ato lidhen me globalizmin e pakontrolluar, krizat afatgjata humanitare, ndryshimet kaotike shoqërore, thyerjen e sistemit të vlerave, luftërat, krimet masive të luftës etj.

Forcimi në të gjithë botën i organizatave dhe partive ultrakonservatore e ekstremiste çon në rritje të rrezikut për sigurinë e qytetarëve, si dhe cenon vlerat themelore dhe të drejtat e njeriut. Fushatat e urrejtjes ndaj armiqve tradicionalë (pakicave kombëtare, fetare dhe seksuale, si dhe ndaj asaj pjese të shoqërisë civile, që konsiderohet bartëse e ideve liberale) janë gjithnjë e më intensive.

Shfaqja e ISIL¹-it dhe e organizatave të tjera terroriste, si dhe sulmet gjithnjë e më të shpeshta terroriste në Europë kanë vënë në pikëpyetje sigurinë e qytetarëve dhe të drejtën themelore të jetës. Aktualisht, shoqëritë bashkëkohore, ku bën pjesë edhe Ballkani Perëndimor, karakterizohen nga lloje të ndryshme të ekstremizmit, të cilat ushqejnë njëra-tjetrën dhe kanë si synim kryesisht rekrutimin e të rinjve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij, vjen për lexuesit me këtë manual, i cili synon të zbërthejë format e ekstremizmit të dhunshëm, faktorët nxitës, kuadrin ligjor ndërkombëtar e vendës në këtë fushë, si dhe rolin e rëndësishëm të organizatave të shoqërisë civile në adresimin dhe parandalimin e tij. Në një pjesë të veçantë të manualit është shpjeguar “procesi i radikalizimit”, faktorët nxitës dhe tërheqës, faktorët e kontekstit dhe njohja e shenjave të radikalizimit.

Në hartimin e këtij manuali kanë marrë pjesë autorë të profesioneve të ndryshme, duke e analizuar fenomenin në aspektin multidisiplinor. Një kontribut të veçantë ka dhënë Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi.

¹ Islamic State of Iraq and Levant (Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit).

Puna e organizatave të shoqërisë civile në parandalimin e ekstremizmit është shumë e rëndësishme, veçanërisht puna me të rinjtë. Për t'u ndier më të sigurt, është me rëndësi që, në gjetjen e zgjidhjeve sistematike për tejkalimin e konflikteve të popullsisë së vendeve të rajonit, të përfshihen segmente të ndryshme të shoqërisë. Kjo nënkupton krijimin e shoqërive të hapura qytetare dhe vendosjen e parimit të sundimit të ligjit, të drejtësisë dhe konceptit të të drejtave të njeriut, bazuar në normat ndërkombëtare. Kësaj i shërben edhe perspektiva e anëtarësimit të vendeve të rajonit në Bashkim European. Në këto procese, puna e OSHC-ve ka rëndësi të madhe dhe aktivitetet në këtë drejtim ndikojnë fort në parandalimin e ekstremizmit.

Në manual janë pasqyruar shembuj të praktikës së mirë për parandalimin dhe adresimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke e vendosur theksin te roli i rëndësishëm dhe komplementar që ka shoqëria civile në këtë drejtim.

Meqenëse vendi ynë ndodhet në një fazë, ku angazhimi i shoqërisë civile në këtë fushë është ende në fillesat e tij, shpresojmë që ky manual t'u vijë në ndihmë të gjithë përfaqësuesve të shoqërisë civile, të cilët duan të kontribuojnë në këtë fushë në mënyrë dinjitoze, inovatore, profesionale dhe konstruktive. Modelet dhe shembujt e praktikës së mirë të përmendura në këtë manual mund të jenë orientuese apo edhe frymëzuese për shoqërinë civile shqiptare. Në çdo rast ato duhet t'i përshtaten kontekstit, përhapjes dhe formave të ekstremizmit të dhunshëm në vendin tonë, si dhe të marrin në konsideratë faktorët ndikues.

2. Ç'ËSHTË EKSTREMIZMI I DHUNSHËM?

Për shkak të dinamikës së fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, nuk ka ende një përkufizim shterues apo të unifikuar të ekstremizmit të dhunshëm, madje as në rang kombëtar. Megjithatë, është rënë dakord që disa akte përbëjnë krime terroriste, të cilat janë forma të ekstremizmit të dhunshëm. Këto akte, si p.sh. rrëmbimi/marrja peng e një avioni, tashmë janë objekt i rregullimit të 18 konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të miratuara nga OKB-ja apo agjencitë e saj.²

“Të gjithë terroristët janë automatikisht ekstremistë. Por, jo të gjithë ekstremistët janë terroristë.” Ekstremistët shprehin dukshëm mendime disidente, por jo detyrimisht mund të jenë të dhunshëm. Sidoqoftë, terroristët shpesh bazohen tek ideologjitë ekstremiste, për të kaluar më pas nga njëra kategori sjelljeje te tjetra. Qeveritë e kanë të vështirë të kuptojnë se cilat lloje të ekstremizmit janë thjesht të papërshtatshme dhe cilat lloje janë më të rrezikshme.”³

Shtetet zotërojnë organizma, të cilët kanë të drejtën dhe detyrimin për të parashikuar dënimin e akteve të dhunshme ekstremiste. Në këtë drejtim, legjislacioni ndërkombëtar ka pësuar zhvillime të ndjeshme, çka ka reflektuar në nevojën për të reformuar dhe përmirësuar edhe legjislacionin e brendshëm nga shtetet që kanë aderuar në konventat dhe traktatet ndërkombëtare. Megjithatë, si fillim, lufta kundër këtij fenomeni kërkon parandalimin e tij. Gjithashtu, është parë e domosdoshme që të angazhohen edhe aktorë të tjerë joshitetërorë, të cilët shërbejnë si partnerë realë për sa i përket ndërgjegjësimit të publikut të gjerë rreth ekstremizmit. Si aktorë të tillë shërbejnë organizatat e shoqërisë civile, bizneset apo media. Këto, përmes bashkëpunimit në nivel lokal dhe përfshirjes së publikut, përshtatin përpjekjet e shtetit me rrethanat vendore, duke rritur kështu efikasitetin në parandalimin e këtij fenomeni.

² Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin – OSCE 2014 <http://www.osce.org/sq/secretariat/123186?download=true>

³ “Nga të dyshuar në qytetarë: Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm në një shoqëri të madhe” (From Suspects to Citizens: Preventing Violent Extremism in a Big Society), Jamie Bartlett dhe Jonathan Bridwell, Demos, UK, 2010, http://www.demos.co.uk/files/From_Suspects_to_Citizens_-_web.pdf?1279732377

3. RADIKALIZMI DHE TË RINJTË

Ç'është radikalizmi?

Radikalizmi është një fjalë me origjinë latine, që do të thotë “rrënjë”, prej nga kemi edhe interpretimin e sotëm, të cilin e përdorim në kuptim të moskompromisit dhe vazhdimësisë në mendim, veprim, teori politike apo, në një kuptim më të gjerë, ideologji të dikujt/një grupi individësh. Ky term përdoret edhe si një simbol i kahjes politike deri në kufijtë e ekstremit. “Radikalizmi” është një koncept i afërt me konceptin “ekstremizëm”, sepse në parim është një veprim që pasohet ose nxitet nga një ideologji “rrënjë”, pa taktikë dhe kompromis të domosdoshëm. Për këtë arsye, në një kuptim më të gjerë ky koncept mund të kuptohet edhe si mënyrë e të jetuarit dhe e pranimit të qëndrimeve të të rinjve, të konsideruar si gjeneratë “e padurueshme”, që kërkojnë të promovohen lehtësisht dhe me ngut, por edhe të përfshihen shpejt e me zhurmë në botën e të rriturve a të vendimmarrësve.

3.1 Cilët janë faktorët e përgjithshëm që ndikojnë në radikalizëm?

Faktorët e përgjithshëm, të cilët ndikojnë në radikalizimin e të rinjve janë:

- i) kriza e identitetit;
- ii) kriza personale;
- iii) rrethanat personale;
- iv) aspiratat e papërbushura dhe,
- v) kriminaliteti.

Kur flasim për **identitet**⁴, kemi parasysh ato karakteristika individuale dhe tipare, përmes të cilave dallojmë një person të caktuar. Përkatësisht, flasim për ato veçori që karakterizojnë një individ, të cilat në periudha të ndryshme kohore mbeten të pandryshueshme dhe njihen si vazhdimësi personale. Identiteti kolektiv (grupor) është një ndjenjë specifike, tipike për pjesëtarët e komunitetit formal apo joformal shoqëror, të cilët ndajnë vlera bazike, kanë ideale, mënyra të të menduarit dhe sjellje të përbashkëta. Përkatësia ndaj identitetit kolektiv del në pah në moshën e adoleshencës, kur bashkëmoshatarët bëhen grup i rëndësishëm, referent, por kjo përkatësi mund të zhvillohet edhe gjatë gjithë jetës.

⁴ Lat. *identitas* – njësi karakteristike.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka pësuar krizë identiteti, e cila shpaloset përmes distancimit nga trashëgimia kulturore, fetare dhe historike, gjë që shkakton një ndjenjë paretie tek individit dhe grupet shoqërore të shoqërive ku bëjnë pjesë. Rrërimi i “*regjimit të vjetër*”, i strukturës monopartiake autoritare të shoqërive të këtij rajoni, më tipare të caktuara të pranuar nga shumica e popullsisë, nuk është zëvendësuar ende me pranimin e koncepteve apo vlerave, mbi të cilat zhvillohen shtetet demokratike moderne, sidomos ato që formojnë Bashkimin Europian.

Mjedisi shoqëror ndikon edhe në **jetën personale e familjare të të rinjve**. Problemet që ndeshin mund të manifestohen si **krizë personale**, krijojnë tensione në familje; individit mund të izohet nga grupi, i nënshtrohet manipulimit brenda familjes, por edhe brenda grupeve të caktuara. Nëse kësaj i shtohet edhe periudha e adoleshencës, gjatë së cilës shfaqet ndjenja e fortë për (vetë)konfirmim, i riu gjendet nën trynë të madhe që të (mos)reagojë në mënyrë radikale, shpeshherë me shumë gabime. Natyrisht që, në këto rrethana, aftësia e vlerësimit apo e gjykimit është e shtrembëruar dhe mund të çojë deri te distancimi i konsiderueshëm nga miqtë e dikurshëm, apo te kërkimi e pranimi i qëndrimeve dhe vlerave të grupeve të reja të miqve. E gjitha kjo nxit një situatë të re të vetëvlerësimit, sidomos në lidhje me identitetin, besimin dhe përkatësinë, si dhe me veprimet specifike të vërtetimit brenda grupit të ri, në përputhje me qëndrimet e reja të pranuar.

Vendi nga vjen i riu dhe **rethanat në të cilat gjendet** kontribuojnë në pranimin e radikalizmit si metodë e të menduarit dhe të vepruarit. Këtu bëjnë pjesë migrimet, si për shembull, ato me natyrë ekonomike, tensionet në komunitetin lokal, ngjarjet në vendin e origjinës, largimi nga vlerat e përgjithshme të shoqërisë, përvojat personale të vuajtjes për shkak të diskriminimit etj.

Proporcionalisht, në nivelin e radikalizimit ndikon dukshëm edhe **kompleksi i objektivave të papërmbushura**, aq i rëndësishëm për të rinjtë, siç është të kuptuarit në mënyrën e vet specifike të konceptit të drejtësisë, pamundësia e plotësimit të dëshirave, shpeshherë joreale, si dhe refuzimi natyror e në mënyrë radikale i vlerave të komunitetit.

3.2 Cilët janë faktorët e jashtëm?

Faktorët e jashtëm që ndikojnë në radikalizim janë të shumtë, disa prej të cilëve po i rendisim më poshtë:

Mediat sociale⁵ - Mediat sociale ‘gjejnë’, kryesisht, përdorues te moshat e reja. Këto media mund të përdoren si një rrugë e lehtë dhe e shpejtë për të shpërndarë statute, për të shprehur qëndrime dhe për të bërë thirrje për veprim, si dhe për të komunikuar ide të caktuara nga grupe të caktuara.

Familja është faktor stabilizues në situata normale. Mirëpo, ne flasim për një rajon, ku shumë vlera janë përmbysur dukshëm, janë mënjeluar shumë qëndrime, plane dhe dëshira⁶, ku nuk respektohen të drejtat themelore të njeriut, duke bërë që edhe familja të humbë funksionin e vet parësor. Nëse askush nuk është i sigurt në një komunitet të caktuar shoqëror dhe politik, nëse shteti, përmes aparatit ideologjik të mbindërtimit, nuk orienton kahun e lëvizjes së shoqërisë, atëherë është e sigurt që familja nuk do të jetë në gjendje të korrigjojë atë që nuk është ‘funksion’ i saj.

Bashkëmoshatarët janë faktor i rëndësishëm në procesin e ‘formatizimit’ të individit të ri. Gjatë procesit të rritjes dhe ndarjes së hapësirës së përbashkët, gjatë gëzimeve, njohjes së botës, “ligjeve” apo rregullave të shoqërisë, njëra prej shfaqjeve të sjelljes në grup është edhe krijimi i qëndrimeve të përbashkëta, të tilla si: tifozeria ndaj të njëjtit ekip sportiv, pjesëmarrja në koncerte të njëjta, argëtimet, krijimi i sjelljeve sipas rregullave apo kodit të grupit. Brenda këtij formati, te bashkëmoshatarët mund të përhapen edhe paragjykime, ide a veprime radikale.

Konteksti shoqëror është hapësira ku lindin të gjitha paragjykimet. Pavarësisht shtrirjes apo rëndësisë së tij, aty krijohen grupet shoqërore. Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor janë në një krizë të thellë prej rreth 30 vjetësh. Për shumë kohë këtu nuk ka pasur gjenerata, të cilat të jenë krijuar në një mjedis paqësor apo në periudha të normalitetit të plotë. Kjo krizë e vazhdueshme ka krijuar shumë efekte negative në shoqëritë e rajonit, aq sa është e vështirë të ofrohen zgjidhje. Në këtë drejtim problematika është thelluar për shkak se elitave të këtyre shoqërive u mungon vullneti për të ofruar politika më të mira publike për rajonin.

⁵ Mediat sociale janë një ndërthurje burimesh të reja të informacioneve online, të krijuara ose iniciuara nga ana e konsumatorit, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve për produkte, marka, shërbime, cilësi dhe tipare. Ato përfshijnë media të shumta dhe të ndryshme, siç janë blogjet, grupet për diskutim, dhomat për chat, e-mail-et, faqet e internetit, forumet, faqet me përmbajtje audio, imazhe, filma dhe fotografi, rrjete sociale.

⁶ “... e kam shitur një parim timin për një copë ëmbëlsirë, nuk kam ngrënë me ditë të tëra...”, The Blondie, Fan Mail.

3.3 Cilët janë faktorët e tjerë?

Në kushtet e tranzicionit afatgjatë, që vazhdojnë të kalojnë vendet e rajonit, ku pushtetet politike nuk janë në gjendje të sigurojnë disa prej funksioneve bazë shtetërore, posaçërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave sociale, shfaqet skamja e madhe, e cila është e vështirë të çrrënjohet. Pasojat e drejtpërdrejta të politikës së padrejtë në rajon janë varfëria dhe papunësia, si dhe ndjenja e mungesës së perspektivës të rinjtë, e cila është rrugë e shkurtër për pranimin e qëndrimeve radikale.

Qëndrimet konservatore ekzistojnë, në një masë të caktuar, në çdo shoqëri. Por, ato shndërrohen në problem kur bëhen dominuese, sidomos kur krijojnë shabllone/modele që nxisin ndarje me baza racore dhe kulturore për pjesëtarët e grupeve të vogla, të komuniteteve etnike apo të ndonjë grupi tjetër pakice. Në shumë raste, lehtësia e pranimin të këtyre qëndrimeve çon deri në radikalizimin e qëndrimeve dhe veprimeve, sipas formulës “ose me ne, ose kundër nesh”.

Praktika e vendeve të rajonit ka evidentuar një perspektivë të kufizuar për të rinjtë dhe të papunët. Mungesa e perspektivës ka shkaktuar valë rebelimi të shumë të rinj, të cilët duke mos u pajtuar me pozitën ku ndodhen, janë nxitur të përfshihen në grupe radikale, ose të krijojnë vetë grupe të tilla.

Kërkimi i identitetit dhe i vetërealizimit është njëri ndër nxitësit e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror. Mirëpo, sidomos për të rinjtë në hapësirën e rajonit tonë, kjo është gjithnjë e më e vështirë që të mundësohet. Arsytet janë nga më elementaret, si për shembull: kriza afatgjatë ekonomike, sistemet e këqija politike dhe në përgjithësi ato shoqërore. Të rinjve nuk u lejohet që të marrin pozita të caktuara dhe, në shumë fusha të ekonomisë e të jetës shoqërore, procesi i zëvendësimit të fuqisë punëtore është i vështirë.

Kthimi i vendeve të rajonit në shtete etnike, “përmbytja” e të gjitha rrjedhave shoqërore brenda kornizave nacionale, pa menduar për më të vegjlit dhe të tjerët, ka nxitur formimin e **stereotipeve dhe paragjyimeve**, të cilat kanë ushqyer lëvizje dhe prirje radikale.

4. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT, SI DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Referuar planit të veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Si çështje e së drejtës ndërkombëtare, terrorizmi nuk është një fenomen i ri. Megjithëse shihet përgjithësisht si fenomen tipik i gjendjes gjeopolitike të botës pas sulmit të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara (9/11), përpjekjet për të krijuar një kornizë të përbashkët në luftën kundër ekstremizmit datojnë që në kohën e Lidhjes së Kombeve. Kjo përpjekje e hershme, e cila rezultoi e pasuksesshme, u iniciua nga qeveria franceze pas vrasjes së mbretit Aleksandër I të Jugosllavisë në Marsejë. Teksti i Konventës së parë për “Parandalimin dhe dënimin e terrorizmit” u miratua në vitin 1937, por për fat të keq, mosmarrëveshjet midis shteteve anëtare nuk bënë të mundur hyrjen në fuqi të saj. Deri më sot nuk ekziston një traktat i vetëm universal që përcakton një përkufizim gjithëpërfshirës të terrorizmit.

Në kuptimin juridik, terrorizmi është një çështje komplekse, që përfshin fushat e së drejtës penale, të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Si rregull, veprimet që zakonisht cilësohen “terroriste” përfaqësojnë: cenimin e së drejtës së jetës, të drejtën për liri dhe siguri ose keqtrajtimin që mund të çojë deri në torturë, trajtim ç’njerëzor dhe degradues. Kur kryhen në kohë konfliktesh të armatosura, ato mund të jenë edhe shkelje të së drejtës humanitare, mund të konsiderohen si krime lufte apo edhe krime kundër njerëzimit. Vrasjet masive, marrja e pengjeve, zhdukja e detyruar apo tortura, janë që të gjitha të ndaluara në mënyrë eksplicite nga e drejta ndërkombëtare, megjithatë përkufizimi dhe koncepti i terrorizmit nuk janë ende të qartë e shterues.

Në mungesë të një traktati të vetëm gjithëpërfshirës, terrorizmi rregullohet nga më shumë se një duzinë traktatesh, të cilat sanksionojnë aspekte të ndryshme të krimeve me natyrë terroriste. Pjesa më e madhe e traktateve relevante për terrorizmin janë hartuar dhe miratuar në kuadër të angazhimeve të përbashkët të shteteve që kanë aderuar në Kombet e Bashkuara. Gjithashtu, ka pasur nisma për legjislacion shtesë ndërkombëtar, por në nivel rajonal, veçanërisht nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European.

Në ditët e sotme, termat “terrorizëm” dhe “ekstremizëm i dhunshëm” përdoren shpesh së bashku dhe ndonjëherë në mënyrë të ndërsjellë, megjithatë ata nuk janë plotësisht sinonim të njëri-tjetrit. Ekstremizmi i dhunshëm është një term më i gjerë, që përfshin aktet terroriste, si dhe akte që nuk mund të kualifikohen si të tilla. Ndërsa terrorizmi ka të bëjë me kryerjen e dhunës së kundërligjshme, me qëllim përhapjen e frikës, në mënyrë që të detyrojë një shtet të bëjë diçka. Duke qenë se gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit terrorizmi është parë si një rrezik i sigurisë kombëtare, që mund të ketë justifikuar përdorimin e masave të ashpra, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha aktivitetet e dhunshme ekstremiste mund të shërbejnë si justifikim për përdorimin e forcës brutale. Kohët e fundit, një dallim midis këtyre termave është vendosur edhe nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, përkatësisht në Rezolutën 2178 (2014), e cila identifikon ekstremizmin e dhunshëm si “ndihmës për terrorizmin”.

Përveç traktateve ndërkombëtare, një burim tjetër kyç i së drejtës ndërkombëtare është e drejta zakonore. Normat e së drejtës zakonore janë rregulla të pashkruara, të cilat praktikisht pranohen dhe respektohen nga shtetet, sepse e ndiejnë si detyrim për ta bërë këtë. Natyrisht që nuk është gjithmonë e lehtë të përcaktohet ekzistenca e një rregulli të caktuar të së drejtës zakonore, por gjykatat ndërkombëtare kanë luajtur një rol vendimtar në parashikimin e këtij burimi të së drejtës. Siç do ta shohim në vijim, kjo është e rëndësishme për terrorizmin.

Së fundmi, një sërë dokumentesh mbi terrorizmin përbëjnë atë që sot quhet “ligj i butë”. Këto dokumente nuk janë ligjërish të detyrueshme për shtetet, por ekziston mundësia që ato të bëhen norma të detyrueshme. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së zakonisht konsiderohen si instrumente të buta ligjore. Nga ana tjetër, ka pasur edhe rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së lidhur me terrorizmin, disa prej të cilave janë adoptuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke i bërë ato të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.

4.1 Ç'është terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm sipas legjislacionit/standardeve ndërkombëtare?

Aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shtetet anëtare, që kanë aderuar në organizata ndërkombëtare, ndihmojnë në përkufizimin e terrorizmit apo të akteve me natyrë terroriste, por sikurse është thënë më sipër, nuk japin një përkufizim gjithëpërfshirës dhe shterues të tij. Ndërkohë, në këto akte nuk përkufizohet nocioni i ekstremizmit të dhunshëm, por parashikohet detyrimi që shtetet anëtare, të cilat kanë aderuar në OKB, të marrin masa për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, si çështje që rrjedh nga rezolutat detyruese të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Rrjedhimisht, diskrecioni i shteteve për të përkufizuar në legjislacionin e tyre të brendshëm “ekstremizmin e dhunshëm” dhe “terrorizmin” është relativisht i gjerë. Megjithatë, përkufizime të tilla, në një mënyrë apo tjetër, duhet të jenë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare. Konkretisht, të gjitha krimet e parashikuara nga traktatet e ndryshme të terrorizmit që këto shtete kanë ratifikuar, duhet të sanksionohen në përputhje me konventat në legjislacionin e brendshëm (të drejtën kombëtare). Si legjislacioni ndërkombëtar, ashtu edhe ai i brendshëm, që parashikon masa parandaluese dhe ndëshkuese ndaj terrorizmit, duhet të respektojnë në mënyrë proporcionale dhe objektive të drejtat dhe liritë e njeriut.

Që nga fundi i viteve '90, ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të miratuar një konventë gjithëpërfshirëse kundër terrorizmit, por deri më tani rezultatet kanë qenë të pasuksesshme. Mosmarrëveshjet e shteteve anëtare qëndrojnë tek elemente të natyrës politike të përkufizimit, kryesisht të lidhura me veprimet e kryera nga forcat e armatosura të shtetit dhe lëvizjet për çlirim kombëtar.

Në mungesë të një përkufizimi të dhënë nga traktatet e miratuara deri më tani për terrorizmin, interes në këtë drejtim paraqet elaborimi që i është bërë këtij koncepti nga gjykatat *ad hoc*, të cilat janë krijuar me mandate të posaçme. Kështu, Tribunali i Posaçëm për Libanin (STL) është krijuar nga një traktat ndërmjet OKB-së dhe Libanit, me qëllim hetimin dhe ndjekjen penale të autorëve të dyshuar për vrasjen e kryeministrit libanez Rafic Hariri, në vitin 2005. Megjithëse në mandatin e tij Tribunali zbaton ligjin libanez, është shqyrtuar edhe legjislacioni ndërkombëtar për terrorizmin, duke iu referuar në mënyrë të veçantë rregullave zakonore të së drejtës ndërkombëtare. Paragrafi 85 i Vendimit Ndërlidhës të STL-së mbi ligjin në fuqi parashikon si vijon:

Ky rregull zakonor kërkon tri elemente kryesore: (i) kryerjen e një vepre penale (si vrasja, rrëmbimi, marrja peng, zjarrvënia etj.), ose kërcënimin për veprime të tilla; (ii) qëllimin për të përhapur frikën në popull (që do të shkaktonte krijimin e rrezikut publik), ose në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të detyronte një autoritet kombëtar a ndërkombëtar për të ndërmarre ose jo një veprim të caktuar; (iii) përfshirjen e një elementi ndërkombëtar në aktin e kryer.

4.2 Cilat janë traktatet e Kombeve të Bashkuara për terrorizmin?

Traktatet me tematika të ndryshme për parandalimin dhe luftën ndaj terrorizmit formojnë atë që mund të konsiderohet si një “kod” i shkeljeve terroriste, të cilat shtetet palë janë të detyruara t’i kriminalizojnë në legjislacionin kombëtar. Në përgjithësi, kur diskutohet për një shkelje të veçantë, konventat e terrorizmit kërkojnë që jo vetëm të parashikohet në ligjin vendës, por kjo shkelje duhet të hetohet dhe të ndëshkohet kudo që mund të ndodhë.

Për këtë arsye, të gjitha traktatet që përcaktojnë shkeljet e dënueshme përdorin nocionin e “juridiksionit universal” si të drejtën e një shteti për të hetuar dhe ndëshkuar një akt të caktuar, pavarësisht se ku është kryer ai (megjithatë autori duhet të paktën të jetë i pranishëm në territorin e tij). Gjithashtu, ato përshkruajnë një detyrim, i cili kërkon që një shtet palë të mbajë një autor të mundshëm të një vepre terroriste në paraburgim ose ta ekstradojë atë person në një vend tjetër, ku do të gjykohej ose ta gjykonte vetë. Në një mënyrë apo tjetër, ato afirmojnë edhe një herë kërkesën për respektimin e legjislacionit ndaj të drejtave të njeriut për terroristët e dyshuar dhe kërkojnë nga shtetet palë që të bashkëpunojnë në çështjet që kanë të bëjnë me ndjekjen e tyre penale.

Konventat e miratuara në këtë fushë pasqyrohen si në vijim:

- a) **Konventa mbi veprat penale dhe vepra të tjera të kryera në bordin e avionit, e vitit 1963** (e njohur si Konventa e Tokios).
- b) **Konventa për Ndalimin e Sekuestrimit të Paligjshëm të Avionëve, e vitit 1970.**
- c) **Konventa për Ndalimin e Veprave të Paligjshme Kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, e vitit 1971** (e amenduar me Protokollin e vitit 1988).
- d) **Konventa mbi Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe agjentët diplomatikë, e vitit 1973.**
- e) **Konventa Ndërkombëtare Kundër Marrjes së Pengejeve, e vitit 1979.**

- f) **Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, e vitit 1979.**
- g) **Konventa për Ndalimin e Veprimeve të Kundërligjshme ndaj Sigurisë së Lundrimit Detar, e vitit 1988** (Protokolli i saj për ndalimin e veprave të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, si dhe protokoli i vitit 2005 që zgjeroi fushën e veprimit të Konventës dhe protokollit të parë të saj).
- h) **Konventa mbi Shënimin e Eksplozivëve Plastikë për Qëllimin e Zbulimit, e vitit 1991.**
- i) **Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, e vitit 1997.**
- j) **Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit, e vitit 1999.**
- k) **Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Veprave të Terrorizmit Bërthamor, e vitit 2005.**

4.3 Cili është kuadri ligjor shtesë i Kombeve të Bashkuara?

OKB-ja dhe organet e saj, kryesisht Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme, kanë miratuar një numër rezolutash me rëndësi për luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe ekstremizmit të dhunshëm. Jo të gjitha këto rezoluta janë të detyrueshme për shtetet anëtare të OKB-së, megjithatë ato janë shumë të rëndësishme dhe disa prej tyre pasqyrojnë qëndrimin e së drejtës zakonore ndaj një çështjeje të caktuar. Rezolutat e Këshillit të Sigurimit, të miratuara sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.

Që nga sulmet terroriste të 11 shtatorit të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Këshilli i Sigurimit është përfshirë gjerësisht në luftën kundër terrorizmit. Pas dënimit të sulmeve, Këshilli i Sigurimit, duke vepruar sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, miratoi unanimisht Rezolutën 1373 (2001), ndër të tjera, edhe duke i detyruar të gjitha shtetet për parandalimin dhe eliminimin e financimit të akteve terroriste; parashikimin si vepër penale të sigurimit me dashje ose grumbullimit me çfarëdo mjeti, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të fondeve nga shtetasit e tyre a në territoret e tyre, me qëllim që këto fonde të përdoren ose me synimin se do të përdoren për të kryer akte terroriste; ngrirjen e menjëhershme të fondeve dhe mjeteve të tjera financiare, ose të burimeve ekonomike për qëllime terroriste etj. Këshilli i Sigurimit evidentoi masa

të mëtejshme që shtetet duhet të ndërmerrnin për të parandaluar dhe ndëshkuar aktet terroriste, duke kërkuar ratifikimin e legjislacionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, në lidhje me të cilin u bëri thirrje të gjitha shteteve të bëheshin palë. Po ashtu, rezoluta e vitit 2001 krijoi edhe Komitetin kundër Terrorizmit, si një degë e Këshillit të Sigurimit, për të monitoruar zbatimin e saj.

Që nga Rezoluta 1373 (2001), Këshilli i Sigurimit ka miratuar edhe një sërë rezolutash të rëndësishme, që kanë të bëjnë me luftën kundër terrorizmit, ku më të rëndësishmet janë: Rezoluta 1535 (2004), për riorganizimin e Komitetit kundër Terrorizmit; Rezoluta 1624 (2005), me anë të së cilës u bëhet thirrje të gjitha shteteve që të miratojnë masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të ndaluar me ligj nxitjen e kryerjes së akteve terroriste; Rezoluta 2178 (2014), në të cilën trajtohet çështja e “luftëtarëve të huaj”, duke i detyruar shtetet të parandalojnë udhëtimin e tyre nga ose përmes territorit të tyre, si dhe duke u kërkuar të marrin masa për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm (duke përfshirë edhe parandalimin e radikalizimit, rekrutimit dhe mobilizimit të individëve në grupe terroriste, apo duke u bërë luftëtarë të huaj terroristë).

Ndryshe nga Këshilli i Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së nuk mund të miratojë rezoluta detyruese. Megjithatë, dokumentet e saj nuk mund të shpërfillen lehtë nga shtetet anëtare. Me Rezolutën 60/288 të vitit 2006, Asambleja e Përgjithshme miratoi Strategjinë Globale të Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit, duke përfshirë një plan veprimi nga ana e shteteve anëtare ndaj luftës kundër terrorizmit, si dhe për të adresuar kushtet që e ndihmojnë atë. Strategjia parashikon katër “shtylla” të luftës kundër ekstremizmit, të fokusuara tek adresimi, parandalimi dhe luftimi i terrorizmit; te ndërtimi i kapaciteteve të shteteve dhe forcimi i rolit të OKB-së; si dhe te garantimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit. Kur është fjala për adresimin dhe parandalimin e kushteve që nxisin terrorizmin, strategjia e vë theksin edhe te pjesëmarrja e një grupi të gjerë aktorësh, sigurisht me përfshirje edhe të shoqërisë civile. Plani i veprimit zbërthen në masa konkrete objektivat e strategjisë, duke parashikuar, ndër të tjera, ndërmarrjen e iniciativave dhe programeve të Kombeve të Bashkuara për të nxitur dialogun, tolerancën dhe mirëkuptimin midis qytetërimeve, kulturave, popujve dhe feve, me qëllim promovimin e respektit të ndërsjellë dhe parandalimin e shpifjeve kundrejt feve, vlerave fetare, besimeve dhe kulturave; promovimin e kulturës së paqes, drejtësisë dhe zhvillimit njerëzor; tolerancën etnike, kombëtare dhe fetare; si dhe respektin ndaj të gjitha feve etj. Zbatimi i kësaj strategjie është përgjegjësi parësore e shteteve anëtare.

Në vitet 2010 dhe 2012, nëpërmjet Rezolutës 64/297 dhe Rezolutës 66/282, Asambleja e Përgjithshme rikonfirmoi rëndësinë e vazhdueshme të Strategjisë Globale kundër Terrorizmit dhe katër shtyllave të saj, si përpjekje e vazhdueshme në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

4.4 Cili është legjislacioni në Europë?

Duke pasur parasysh përhapjen gjeografike të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, përpjekjet më të mëdha për t'i luftuar ato kanë ndodhur në nivel të OKB-së. Po ashtu, janë ndërmarrë edhe nisma në nivel europian, kryesisht nën kujdesin e Këshillit të Europës, si dhe Bashkimit Europian. Këto traktate plotësojnë legjislacionin ekzistues universal kundër terrorizmit.

Konventa Europiane e vitit 1977 “Për ndalimin e terrorizmit” trajton kryesisht ekstradimin e autorëve të akuzuar për kryerjen e akteve terroriste. Ajo mbështetet qartësisht në dispozitat e traktateve universale kundër terrorizmit që janë në fuqi, duke i detyruar shtetet palë që të mos i cilësojnë veprat penale të përcaktuara nga Konventa e Rrëmbimit të Hagës e vitit 1970 dhe Konventa e Montrealit e vitit 1971, si sulme/akte me natyrë politike. Në procedurat e ekstradimit, nocioni i “sulmeve politike” është i një rëndësie të veçantë, kjo sepse individët që mund të kërkohet të ekstradohen nga një shtet i huaj për akte të tilla, për arsye politike, mund të jenë viktimat të persekutimit. Prandaj, në të tilla raste, shteti ndalues nuk duhet ta lejojë ekstradimin. Gjithashtu, shtetet palë janë të detyruara të mos i cilësojnë si akte të motivuara politikisht veprat e rënda kundër jetës, integritetit fizik ose lirisë së personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe agjentët diplomatikë, nëse ato shoqërohen me elemente të tilla si: rrëmbimi, marrja e një pengu ose ndalimi i paligjshëm, përdorimi i bombave, granateve, raketave, armëve të zjarrit (nëse nga përdorimi rrezikohen individët), tentativa për të kryer këto vepra ose bashkëpunimi, si dhe kur këto vepra drejtohen kundër pasurisë, nëse krijohet një rrezik kolektiv për njerëzit. Në vitin 2003, konventa u ndryshua me një protokoll, i cili zgjeroi listën e veprave penale me natyrë terroriste.

Përtej kuadrit ligjor të Këshillit të Europës, ekziston një konsensus i gjerë, sipas të cilit, aktet terroriste, për shkak të peshës së veçantë që kanë dhe duke qenë se zakonisht kryhen për motive politike, në procedurat e ekstradimit nuk cilësohen si sulme politike. Megjithatë, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ndaj personave të dyshuar për terrorizëm kërkojnë ndalimin e ekstradimit të tyre, nëse ata përballen me një rrezik real të keqtrajtimit në shtetin tjetër.

Në vitin 2005 u miratua Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin e Terrorizmit. Konventa e cilëson “aktin terrorist” si një nga veprat e renditura në traktatet universale kundër terrorizmit. Gjithashtu, ajo parashikon masat e përshtatshme që shtetet palë duhet të ndërmarrin për parandalimin e veprave terroriste, veçanërisht në fushën e trajnimit të institucioneve ligjzbatuese, si dhe në fushat e edukimit, kulturës, informimit, mediave dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik. Këto masa duhet të respektojnë detyrimet përkatëse për të drejtat e njeriut. Konventa përcakton tri vepra penale shtesë, të cilësuar si terroriste, të cilat më pas duhet të përfshihen në legjislacionin penal në nivel kombëtar dhe të parandalohen nga shtetet palë. Këtu bëjnë pjesë:

- a) “Provokimi publik për kryerjen e një akti terrorist”, i cili përkufizohet si shpërndarja ose vënia në dispozicion e një mesazhi për publikun, me synimin për të nxitur kryerjen e një akti terrorist, edhe kur një sjellje e tillë, pavarësisht nëse synon ose jo drejtpërdrejt një akt terrorist, përbën rrezik për kryerjen e një apo më shumë akteve të tilla;
- b) “Rekrutimi për terrorizëm” përkufizohet si thirrja e një personi ndaj të tretëve për të kryer ose marrë pjesë në kryerjen e një akti terrorist, apo për t’u bashkuar me një organizatë (ose grupim), me qëllim ndihmën ndaj saj për kryerjen e një ose më shumë veprave terroriste;
- c) “Trajnime për terrorizëm” përkufizohet si dhënia e udhëzimeve në krijimin ose përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit apo armëve të tjera, substancave të dëmshme e të rrezikshme, si dhe dhënia e udhëzimeve në metoda a teknika të tjera të posaçme, me qëllim kryerjen e një akti terrorist apo ndihmën për të kryer një akt të tillë, duke qenë i ndërgjegjshëm se aftësitë e përfituara do të përdoren për këtë qëllim.

Zhvillimet e legjislacionit për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit në Bashkimin Europian kanë datuar më vonë në kohë. Në vitin 2005 u miratua strategjia e BE-së kundër terrorizmit, e cila mbulon katër fusha: “parandalimin”, “mbrojtjen”, “ndjekjen” dhe “reagueshmërinë ose përgjigjen”. Strategjia e BE-së është kryesisht një dokument politikash, që vendos përgjegjësinë kryesore për luftën kundër terrorizmit në nivel kombëtar, por që përcakton edhe mënyrat, nëpërmjet të cilave BE-ja mund të “shtojë vlerat” në këtë luftë (p.sh., nëpërmjet forcimit të aftësive kombëtare, lehtësimit të bashkëpunimit europian, zhvillimit të aftësive kolektive dhe promovimit të partneritetit ndërkombëtar).

4.5 Si paraqitet terrorizmi në situatat e konfliktit të armatosur?

E Drejta Ndërkombëtare Humanitare (DNH), e njohur edhe si ligji i konfliktit të armatosur, kërkon të kufizojë aktet dhe pasojat brutale të konfliktit të armatosur, pavarësisht nëse ky konflikt është në nivel ndërkombëtar⁷ apo kombëtar⁸. DNH-ja mbron personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në luftë, duke përfshirë civilët, të plagosurit, pjesëtarët e sëmurë të forcave të armatosura, të burgosurit e luftës, personelin mjekësor etj.

Megjithatë, në situatat e konfliktit të armatosur, për shkak të rrethanave ekstreme, DNH-ja vlerësohet më pak mbrojtëse se të drejtat e njeriut. Për shembull, standardet e të drejtave të njeriut kërkojnë që ndërhyrja me pasojë vdekjen të përdoret jo në masë më të madhe nga sa është absolutisht e nevojshme për të mbrojtur jetën apo gjymtimin e çdo personi (pra, të jetë masa e fundit). Ndërkohë, sipas së drejtës humanitare, forca mund të përdoret gjithmonë kundër një objekti ushtarak, ose kundër personave që marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt, me kusht që humbjet e pritura civile të mos e tejkalojnë përparësinë ushtarake që vjen nga sulmi, si dhe të merren të gjitha masat e mundshme për të mbrojtur popullsinë civile.

Në SHBA, përpara sulmeve të 11 shtatorit, lufta kundër terrorizmit shihej kryesisht nëpërmjet modelit të zbatimit të ligjit. Pas 11 shtatorit dhe shpalljes globale të një “Luftë kundër terrorizmit”, një numër shtetesh që u pozicionuan në luftën kundër terrorizmit përdorën masa që ndaloreshin nga të drejtat e njeriut në kohë paqeje, të tilla si përdorimi i menjëhershëm i ndërhyrjeve vdekjeprurëse dhe privimi i lirisë për arsye urgjente të sigurisë. Edhe pse nuk është më kontradiktore që të drejtat e njeriut të respektohen në situatat e konfliktit të armatosur, në rastet kur ekziston një konflikt normash ndërmjet DNH-së dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut, DNH-ja zakonisht prevalon si *lex specialis*.

Në rastet e konfliktit të armatosur, DNH-ja trajton çështjen e terrorizmit në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe kombëtare. Lidhur me të parën, Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës, i vitit 1949, ndalon veprimet ose kërcënimet me dhunë, qëllimi kryesor i të cilave është përhapja e terrorit në popullsinë civile, ndërsa Konventa e Gjenevës ndalon “të gjitha masat e kanosjes

⁷ Kur lufta zhvillohet midis dy ose më shumë shteteve.

⁸ Referuar një situatë të dhunës së zgjatur e të armatosur ndërmjet autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara, apo midis grupeve të tilla brenda një shteti.

dhe të terrorizmit". Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), ndalimi i përhapjes së terrorizmit është një normë e së drejtës zakonore dhe ekziston pavarësisht nëse një shtet e ka ratifikuar ose jo protokollin. Megjithatë, duhet të merret parasysh se DNH-ja ndalon edhe veprimet që zakonisht përshkruhen si "terrori i shtetit". Përveç kësaj, pavarësisht nga qëllimi specifik për përhapjen e terrorizmit, të drejtat e njeriut ndalojnë sulmet ndaj personave dhe pronës, të cilat zakonisht janë objektiv i veprimtarisë terroriste. Kjo përfshin vrasjen e civilëve dhe shkatërrimin e pronës civile, vrasjen masive, bombardimin pa dallim, përdhunimin, torturën dhe pengmarrjen.

4.6 Si paraqitet terrorizmi në raport me të drejtat e njeriut?

Për shumë arsye, terrorizmi paraqet një sfidë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga njëra anë, shtetet kanë një interes të ligjshëm për të luftuar terrorizmin. Po ashtu, ato janë të detyruara të mbrojnë në çdo kohë jetën, sigurinë dhe lirinë e të gjithë personave nën juridiksionin e tyre. Më anë tjetër, edhe personat që angazhohen në aktivitete terroriste janë qenie njerëzore, që duhet të gëzojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, aq sa është e mundur nga rrethanat. Në shumë raste, përpjekja për të arritur një ekuilibër ndërmjet këtyre të dyjave i vendos shtetet përpara një sfide.

Ekzistojnë një sërë traktatesh në nivel universal dhe rajonal për të drejtat e njeriut, të cilat mbrojnë të njëjtat të drejta themelore, duke përfshirë të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor dhe degradues (keqtrajtimi), të drejtën për liri dhe siguri të personit, të drejtën për gjykim të drejtë, parimin e ligjshmërisë, si dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Të gjitha këto të drejta respektohen në luftën kundër terrorizmit, ndonëse disa mund të kufizohen nga zbatimi në të njëjtën kohë i DNH-së në një situatë konflikti të armatosur (në të shumtën e rasteve, e drejta e jetës).

Në rastet e jashtëzakonshme të emergjencës publike ("kërcënimi i jetës së kombit"), traktatet e të drejtave të njeriut parashikojnë një procedurë për shmangien nga standardet e zakonshme që shtetet duhet të respektojnë. Shmangie të tilla mund të bëhen vetëm atëherë kur e kërkojnë rrethana rreptësisht të jashtëzakonshme. Përveç kësaj, ka të drejta themelore që nuk mund të shmangen nga asnjë rrethanë. Këtu përfshihen e drejta e jetës (e cila është e pacenueshme, por jo absolute), ndalimi i keqtrajtimit, ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar dhe parimi i mosdënimit pa u mbështetur në ligj.

Disa shtete kanë mbrojtur qëndrimin se “vrasja e shënjestruar” e terroristëve nuk përfaqëson shkelje të së drejtës së jetës. Megjithatë, standardet e të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo forcë e përdorur të jetë e ligjshme, të jetë absolutisht e nevojshme për të shmangur një kërcënim të menjëhershëm ndaj jetës, gjymtimin e një personi apo ekzekutimin e një arrestimi të ligjshëm, si dhe të shmanget në masën më të madhe të mundshme humbja e jetës/jetëve. Sipas analizës së disa studiuesve, vrasjet e shënjestruara janë pothuajse gjithmonë të papajtueshme me standardet e të drejtave të njeriut.

Keqtrajtimi i terroristëve të dyshuar është një praktikë e aplikuar nga qeveri të caktuara, të cilat, nënshtrimin e personave që janë nën juridiksionin e tyre, ndaj akteve të torturës, të tilla si ‘mbytja me ujë’⁹, e justifikojnë me argumente të ndryshme pseudo-ligjore. Praktika të tilla janë justifikuar kundrejt personave të akuzuar për terrorizëm, si për shembull, për ‘skenarë të mundshëm të vendosjes së bombës me sahat’. Në këto raste, autoritetet e justifikojnë përdorimin e praktikave torturuese, me qëllim marrjen e informacionit nga i akuzuari për skenarin e mundshëm, që mund të shpëtojë jetë të shumta e të pafajshme. E drejta ndërkombëtare nuk e lejon torturën edhe në një situatë të tillë. Ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ka karakter absolut dhe e drejta për të mos iu nënshtruar këtyre akteve nuk mund të shmanget në asnjë rrethanë. Kjo qasje është universale dhe e përbashkët për shumicën e shteteve. Argumente të tilla kanë filluar të zbehen, pasi disa qeveri, të cilat e kanë përdorur dikur këtë praktikë, tani e refuzojnë torturën si një instrument në luftën kundër terrorizmit.

Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut është pranuar nga komuniteti ndërkombëtar si i rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Veçanërisht, Strategjia Globale Kundër Terrorizmit e OKB-së, si dhe një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurimit, siç është rezoluta e fundit 2255 (2015), risjellin të gjitha detyrimet e shteteve anëtare për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, refugjatëve dhe së drejtës humanitare.

Përveç sa më sipër, respektimi i plotë i të drejtave universale të njeriut do të kishte një efekt të konsiderueshëm edhe në zhdukjen e burimit të radikalizmit, i cili çon në terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm që njohim sot.

⁹ Waterboarding është një formë e torturës me ujë, sipas së cilës uji derdhet mbi një leckë që mbulon fytyrën dhe rrugët e frymëmarrjes të një personi, i cili mbahet i mbërthyer që të mos lëvizë, duke i shkaktuar ndjesinë e mbytjes.

5. SI ADRESOHET EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KUADRIN TONË LIGJOR KOMBËTAR (SHQIPËRIA)?

5.1 Përse është i nevojshëm një kuadër ligjor dhe institucional kundër ekstremizmit të dhunshëm?

Duke pasur parasysh përhapjen globale të ekstremizmit të dhunshëm dhe zhvillimet e legjislationit a të politikave që adresojnë këto fenomene në nivel ndërkombëtar, qeveria shqiptare i ka kushtuar një vëmendje të veçantë përmirësimit dhe harmonizimit të kuadrit tonë të brendshëm ligjor dhe institucional në këtë fushë, sidomos gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit. Ndikim në këtë drejtim kanë pasur edhe dinamikat e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm në kontinentin e Europës, sidomos aktet brutale me natyrë terroriste, shënjestër e të cilave kanë qenë shtete të zhvilluara të Bashkimit Europian.

Nevoja për një kuadër të tillë vjen jo vetëm për shkak të detyrimeve që ka vendi ynë si anëtar i Këshillit të Europës dhe i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, as thjesht si rezultat i bashkëpunimit të mirë me shtetet në nivel bilateral a multilateral, por edhe për shkak të detyrimeve që ka shteti për të mbrojtur nga ekstremizmi i dhunshëm, i shfaqur në të gjitha format e tij dhe në mënyrë të veçantë nga terrorizmi, institucionet dhe shtetasit që jetojnë e banojnë në territorin e vendit tonë.

5.2 Cilat janë konventat/marrëveshjet ndërkombëtare që ka ratifikuar vendi ynë?

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar një sërë konventash dhe protokollesh për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, të cilat janë **bërë pjesë e sistemit tonë të brendshëm ligjor** dhe afrojnë vullnetin e përbashkët të shteteve palë në këtë fushë, në kuadër të aderimit të tyre në Kombet e Bashkuara dhe në Këshillin e Europës. Në këtë fushë, vendi ynë ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me shtete të ndryshme. Për shkak të rrezikut që u kanoset shteteve dhe popujve nga ekstremizmi i dhunshëm, në mënyrë të veçantë nga terrorizmi, ajo që bie në sy është shpejtësia me të cilën janë ratifikuar këto konventa edhe nga vendi ynë.

Shqipëria është bashkësponsorizuese e Rezolutës 2178 (2014) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ndërkohë që konventat më të rëndësishme të ratifikuara prej saj janë si më poshtë: Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Bombardimeve Terroriste, Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Financimit të Terrorizimit, Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Nuklear, Konventa Europiane për Shtypjen e Terrorizmit dhe Protokolli i saj, Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin e Terrorizmit dhe protokolli i saj shtesë etj. Ndër marrëveshjet më të rëndësishme bilaterale që vendi ynë ka nënshkruar, duke ndërmarrë angazhime të ndërsjella me vende të tjera fqinje dhe në rajon, me qëllim adresimin e terrorizmit në dimensione të ndryshme të tij, janë marrëveshja me Qeverinë e Republikës së Hungarisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar (15.6.2000), marrëveshja me Qeverinë e Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe luftës kundër krimit të organizuar etj. (3.10.2002), marrëveshja me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar etj. (4.11.2004), si dhe një sërë marrëveshjesh të kësaj natyre me vende të tjera.

5.3 Cilat janë veprat penale që dënojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?

Nisur nga rekomandimet dhe Konventat e Këshillit të Europës mbi luftën kundër terrorizmit, të cilat kërkojnë që krimet e terrorizmit të përafrohen në të gjitha shtetet anëtare, në mënyrë që lufta ndaj këtij fenomeni të bëhet më e lehtë, edhe vendi ynë ka përmirësuar legjislacionin penal. Vitet e fundit është vërejtur një ashpërsim i politikës penale, me kriminalizimin e formave të reja të veprave penale në këtë fushë, si dhe me ndryshimin e dispozitave ekzistuese. Në kodin tonë penal parashikohet një kre i posaçëm, që sanksionon veprat penale me natyrë terroriste, përkatësisht dispozitat e *Kreu VII "Vepra me qëllime terroriste"*, nenet 230 e në vijim të tij¹⁰. Zhvillimet që ka pësuar legjislacioni ndërkombëtar dhe aderimi i vendit tonë në një sërë konventash, të cilat u përmendën më sipër, kanë çuar në ndryshimin e vazhdueshëm të këtij kreu, i cili është pasuruar me forma të reja të kriminalitetit në fushën e terrorizmit, por ka pësuar ndryshime edhe në veprat ekzistuese penale në këtë fushë.

¹⁰ Nenet: 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 231, 232, 232/a, 232/b, 234/a

Te kreu në fjalë dënohen me dënime të ashpra, në disa raste edhe me dënim të përjetshëm, veprat penale me qëllime terroriste; financimi i terrorizmit; fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, nëpërmjet të cilave financohet terrorizmi; dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike apo që ushtrojnë profesionin e tyre në lidhje me verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit; rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit etj.

Gjithashtu, kodi ynë penal parashikon mbrojtje edhe nga një sërë veprimesh të kundërligjshme, me elemente të ekstremizmit të dhunshëm, të cilat dënohen penalisht. Neni 265 i kodit penal dënon nga dy deri në 10 vjet nxitjen e urrejtjes dhe të grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitjen, përhapjen ose ruajtjen e materialeve me përmbajtje të tilla. Dënohet nga 2 deri në tetë vjet vënia në rrezik e paqes publike, si në rastet kur bëhet thirrje për urrejtje kundër pjesëve të caktuara të popullsisë, duke i fyer ose duke shpifur për to, si dhe duke kërkuar përdorimin e dhunës apo të veprimeve arbitrare kundër tyre (n. 266). Dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet përhapja e informatave të rreme, të cilat ngjallin panik dhe pasiguri te njerëzit (n. 267).

5.4 Ku dallon vepra penale në fushën e terrorizmit nga veprat e tjera penale?

Kodi ynë penal, në nenin 230 të tij e përkufizon veprën penale të terrorizmit duke përcaktuar elementet thelbësore të saj. Dallimi nga veprat e tjera penale ka të bëjë me **qëllimin** që ajo mund të ketë; me **përhapjen e panikut në popullatë apo detyrimin e organeve shtetërore, shqiptare dhe të huaja, që të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar**; si dhe me **shkatërrimin apo destabilizimin, në mënyrë serioze, të strukturave thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike a sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, të një institucioni apo të një organizate ndërkombëtare**.

Nga ana objektive, kjo dispozitë rendit në mënyrë joshteruese veprimet e kundërligjshme me natyrë terroriste, të drejtuara kundër individit, të cilat mund të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë; rrëmbimin me dhunë ose kanosjen e avionëve, anijeve, mjeteve të tjera të transportit apo të platformave fikse, po ashtu edhe ushtrimin e paligjshëm të kontrollit mbi to; kryerjen e akteve të dhunës kundër një personi në bordin e një avioni në fluturim, në bordin e një anijeje, ose

në bordin e një platforme fikse, apo shkatërrimin e këtyre të fundit; pengmarrjen ose rrëmbimin e dikujt dhe kanosjen për të vrarë, për të plagosur ose për të vazhduar mbajtjen e tij peng; vjedhjen, përvetësimin apo përfitimin nëpërmjet mashtrimit, të materialeve bërthamore etj. Lista e veprimeve të kundërligjshme për qëllime terroriste nuk është shteruese, pasi legjislatori ka parashikuar edhe çdo vepër tjetër që synon të shkaktojë vdekjen apo plagosjen e rëndë të civilëve ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në veprimet luftarake në një situatë konflikti të armatosur, të kryer për qëllimet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm.

5.5 A dënohet penalisht pjesëmarrja e shtetasve shqiptarë në veprime luftarake jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë?

Në korrik të vitit 2014, kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin 98/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, ku ndër të tjera, në kreun VIII të tij, që dënon krimet kundër autoritetit të shtetit, u shtuan tri vepra të reja penale¹¹.

Këto vepra penale dënojnë pjesëmarrjen në veprime luftarake në një shtet të huaj, organizimin për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj, si dhe thirrjen për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj. Kriminalizimi i këtyre veprimeve të kundërligjshme mori shkas nga përfshirja e një numri jo të vogël shtetasish shqiptarë në formacione luftarake, në konflikte të armatosura që zhvillohen në territorin e shtetit sirian. Këta shtetas shqiptarë, edhe pse nuk mbajnë njëkohësisht shtetësinë siriane dhe nuk janë dërguar në misionet ushtarake nga shteti shqiptar, as nga ndonjë shtet tjetër ndërluftues apo organizatë ndërkombëtare, kanë konsumuar veprime të dhunshme, të cilat sipas kuvendit do të duhet të penalizohen nga e drejta jonë penale, në të njëjtën mënyrë siç i penalizojnë veprime të tilla edhe një sërë shtetesh të tjera.

Fillimisht ka qenë Këshilli i Sigurimit i OKB-së që miratoi rezolutën nr. 405/1977, ku dënohej mercenarizimi i përdorur si instrument për veprime të dhunshme e luftarake në territorin e një shteti sovran. Në vijim u miratua Konventa e OKB-së¹² kundër rekrutimit, përdorimit, financimit dhe trajnimit të mercenarëve. Vendi ynë rezultoi të mos ketë nënshkruar, e për rrjedhojë, edhe ratifikuar këtë konventë, duke sjellë si pasojë ekspozimin e normativës penale shqiptare ndaj mangësisë në trajtimin e rasteve, kur shtetasit shqiptarë marrin pjesë dhe luftojnë në veprime të dhunshme a konflikte të armatosura jashtë territorit të kontrolluar nga shteti shqiptar, pa qenë dërguar në këto territore me misionet ushtarake zyrtare.

¹¹ 265/a, 265/b dhe 265/c të kodit.

¹² New York 1989

Pavarësisht se Shqipëria nuk ka aderuar në këtë konventë, duke pasur parasysh problematikën e sipërpërmendur, si dhe zhvillimet në legjislacionin e vendeve fqinje dhe në rajon (si Kosova, Italia apo Franca), vendi ynë iu referua modelit francez, kodi penal i të cilit ka si pjesë të dispozitave të tij nene të veçanta në lidhje me veprimtarinë e mercenarizmit. Tri dispozitat e shtuara në kodin tonë penal i dënojnë vepra të tilla me dënime që shkojnë nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet burg, vepra të cilat cenojnë marrëdhëniet paqësore të shtetit shqiptar me shtete të huaja, të njohura ndërkombëtarisht. Gjithashtu, ato cenojnë autoritetin shtetëror, për sa kohë thirrja nën armë e shtetasve, rekrutimi, organizimi në formacione luftarake dhe dërgimi i tyre si palë ndërluftuese është një prerogativë ekskluzive shtetërore.

5.6 A parashikon legjislacioni ynë masa të tjera shitesë për të parandaluar dhe goditur financimin e terrorizmit?

Përveç dispozitave të parashikuara në kodin penal, vendi ynë ka miratuar ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, qëllimi i të cilit është parandalimi dhe goditja e veprimtarive të terroristëve, e individëve që e mbështesin a financojnë terrorizmin, apo e atyre ndaj të cilëve ngrihen dyshime të bazuara se kanë kryer, po kryejnë apo kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla. Kjo do të realizohet nëpërmjet bllokimit apo sekuestrimit të fondeve dhe pasurive të tyre.

Gjithashtu, Shqipëria ka miratuar ligjin nr. 66/2012, të datës 07.06.2012, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, i cili synon të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. Këtij ligji i nënshtrohen një sërë subjektesh, të cilat mund të jenë persona fizikë ose juridikë që vendosin marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tyre normale, tregtare apo profesionale. Subjektet duhet të marrin ndaj klientit masat e duhura të vigjilencës¹³, të cilat në disa raste janë të parashikuara në këtë ligj.

¹³ Neni 19/1, “Vigjilenca e duhur” është tërësia e masave që duhet të aplikojnë subjektet, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë e të saktë të klientëve, të pronarit përfitues përfundimtar, të strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, për natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo të marrëdhënies, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit e të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, me qëllim që të sigurohet se janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, edhe burimin e fondeve.

Rregullorja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, e vitit 2015, “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, përcakton procedurat dhe dokumentacionin për identifikimin e klientit, regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës, që është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP). Në prill të vitit 2017, edhe Banka e Shqipërisë (BSH) ka miratuar rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, qëllimi i së cilës është parandalimi i përdorimit të subjekteve për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

5.7 A ka miratuar vendi ynë dokumente strategjike për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm?

Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendimin nr. 930, të datës 18.11.2015, “**Strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planin e veprimit**”. Me anë të këtij dokumenti strategjik, shteti ynë zotohet më tej në thellimin e masave për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, duke përfshirë dhe bashkëpunuar jo vetëm me agjenci të specializuara ligjzbatuese apo me institucionet përgjegjëse shtetërore, por edhe me publikun e gjerë, organizatat e shoqërisë civile, të rinjtë, gratë, rrjetet fetare, kulturore dhe arsimore. Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie janë ngarkuar katër ministri, përkatësisht: ministrinë që mbulojnë çështjet sociale, të arsimit, punët e brendshme dhe të jashtme.

Misioni i strategjisë është ruajta e vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtja e të drejtave të njeriut, e shtetit të së drejtës dhe demokracisë, si dhe mbrojtja e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në veprimet kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, për të trajtuar me më shumë efektivitet kushtet që çojnë drejt radikalizimit.

Nëpërmjet kësaj strategjie synohen të arrihen këta objektiva:

- a) *Forcimi i bashkëpunimit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, për të realizuar ndërhyrje efektive;*
- b) *Nxitja e kërkimeve për të kuptuar kushtet aktuale të zhvillimit dhe të promovimit të këtij fenomeni;*
- c) *Forcimi i qëndresës në komunitet;*
- d) *Ulja e numrit të personave të rekrutuar (nëpërmjet medias, rrjeteve sociale etj.).*

Me ligjin nr. 72/2015, vendi ynë ka miratuar Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë. Përveç mbrojtjes së interesave e vlerave kombëtare, kjo strategji promovon edhe mbrojtjen e interesave dhe të vlerave perëndimore të Aleancës Euroatlantike. Në lidhje me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, në këtë strategji vihet në dukje kërcënimi serioz dhe i drejtpërdrejtë i sigurisë, i stabilitetit dhe i prosperitetit në nivel global e rajonal, çka mund të frymëzojë grupe ekstremiste, të cilat synojnë përhapjen e ideologjive ekstremiste dhe ndërmarrjen e akteve terroriste në zonën euroatlantike, duke përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë.

Strategjia e paraqet mjedisin brenda vendit si të sigurt, me tipare të qëndrueshme dhe me prirje drejt një përmirësimi të dukshëm cilësor. Kjo ka ardhur edhe si rezultat i anëtarësimit në NATO dhe perspektivës së anëtarësimit në BE. Megjithatë, pozita gjeografike, mungesa e shërbimeve shtetërore, si dhe lidhjet e shumëfishta rajonale dhe ndërkombëtare e vendosin vendin tonë në pozita të favorshme për një rrezik të mundshëm nga sulmet terroriste, trafiket e ndryshme apo emigracioni i paligjshëm, fenomene të cilat mbeten sfida kryesore për Shqipërinë. Këshilli i Ministrave zotohet se do të mbështesë reformat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për modernizimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre, me qëllim që të jenë gjithmonë të gatshme në përmbushjen e misionit kushtetues për garantimin e sigurisë në vend. Strategjia njeh dhe vlerëson faktin që, krahas rreziqeve a sfidave ndaj sigurisë, rajoni i Ballkanit ofron edhe shumë mundësi që duhet të shfrytëzohen në interes të sigurisë dhe paqes rajonale. Prania e OKB-së, e NATO-s, e BE-së, e OSBE-së dhe e shumë organizmave të tjerë të sigurisë, është një ndër shtyllat kryesore të stabilitetit dhe bashkëpunimit në rajon.

6. SI DUHET TË NDËRVEPROJNË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR TË PARANDALUAR E ADRESUAR RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN?

Kontributi i organizatave të shoqërisë civile njihet në të gjitha strategjitë ndërkombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Përfundimet e shumë konferencave ndërkombëtare (duke përfshirë edhe ato të organizuara nga BE-ja, OKB-ja, OSBE-ja) ilustrjnë qasjen shumëdimensionale dhe lidhen me aktorët e shoqërisë civile, si partnerë kryesorë në trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm¹⁴.

Duke pasur parasysh natyrën e ndërlikuar shumëplanëshe dhe ndërdisiplinore të ekstremizmit e radikalizimit, përfshirja e OSHC-ve dhe vendosja e urave të bashkëpunimit me këto organizata është shumë e nevojshme. Ka një spektër të gjerë të rolit që mund të luajë shoqëria civile për të parandaluar dhe adresuar ekstremizmin dhe radikalizmin.

Organizatave të shoqërisë civile mund të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve që kanë në fokus, të edukojnë dhe informojnë publikun për pasojat dhe dëmet që shkakton ekstremizmi apo të sinjalizojnë mbi rastet e mundshme ose ngjarje të natyrës ekstremiste, si dhe të ndikojnë në parandalimin dhe adresimin e faktorëve nxitës të tyre.

Organizatave mund të veprojnë edhe si avokatë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si në rastin kur të drejtat e personave të dyshuar ose të akuzuar për vepra të natyrës terroriste, mund të cenohen në proceset hetimore apo gjyqësore, por nga ana tjetër edhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të viktimave të këtyre veprave. Organizatave mund të ndërmarrin studime dhe hulumtime për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, për faktorët nxitës dhe për rolin e institucioneve në parandalimin a luftën ndaj këtij fenomeni. Këto studime apo dokumente të tjera me natyrë kërkimore rrisin ndërgjegjësimin e institucioneve, të shoqërisë dhe të publikut mbi fenomenin dhe pasojat e tij, duke u bërë shpeshherë promotorë apo katalizatorë i ndryshimeve ligjore dhe institucionale.

¹⁴ Shihni dokumentet: Fletë faktesh e OSBE-së për veprimtaritë e saj në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. <http://www.osce.org/secretariat/144741?download=true>; Raporti i parë i grupit të punës për radikalizimin dhe ekstremizmin që çon në terrorizëm, <http://www.un.org/en/terrorism/pdfs/radicalization.pdf>

Kontributi i organizatave në nivel vendor mund të shtrihet në drejtim të lehtësimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të ekstremizmit, siç mund të jenë ato ekonomike, shoqërore dhe politike, nëpërmjet zbatimit të një sërë programesh e veprimtarish, të cilat kanë si synim parësor komunitetin apo bashkëpunimin në kuadër të programeve të gjera të menaxhuara nga shteti.

Disa nga veprimtaritë ku organizatat e shoqërisë civile kanë kapacitetin për t'u përfshirë në parandalimin dhe adresimin e ekstremizmit të dhunshëm janë si më poshtë:

- a) Organizimi i veprimtarive që kanë në fokus nxitjen e debatit publik dhe thithjen e mendimit të qytetarëve për problematikat apo zgjidhjet që lidhen me ekstremizmin;
- b) Organizimi i veprimtarive të tilla si tryeza të rrumbullakëta, seminare apo forume, të cilat synojnë vendosjen e dialogut politik, ndërftar dhe ndërkulturor, si dhe promovimin e tolerancës lidhur me identitetin, kulturën, fenë apo të drejtat e njeriut;
- c) Rritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përfaqësuesve të vetë shoqërisë civile, të medias, të rinjve, komuniteteve fetare, nëpunësve civilë apo aktorëve të sistemit të drejtësisë, lidhur me një spektër të gjerë dhe shumëplanësh (sipas grupit përfaqësues që trajnohet) të adresimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm;
- d) Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të veçanta që kanë në fokus edukimin e të rinjve apo integrimin e grupeve në nevojë, të cilat mund të jenë të rrezikuara nga ekstremizmi apo rekrutimi i grupeve ekstremiste.
- e) Promovimi i politikave publike nëpërmjet lobimit dhe advokacisë (që përfshin identifikimin e problemit dhe nxjerrjen e një sërë rekomandimesh për zonat e ekspozuara ndaj P/LKEDh);
- f) Ndjekja, monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të kuadrit ligjor, i dokumenteve strategjike dhe i politikave të tjera të institucioneve shtetërore, me qëllim adresimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm etj.

Veprimtaritë e OSHC-ve në fushën e ekstremizmit të dhunshëm duhet t'i përshtaten kontekstit vendës dhe në mënyrë të veçantë zonës e veçorive të popullatës ku do të zbatohen këto veprimtari, nëse ato janë të lokalizuara. Për shkak të kontakteve dhe kapaciteteve të tyre, organizatat mund të vlerësojnë në mënyrë të drejtë nevojat e komunitetit dhe ndërhyrjet e domosdoshme, si masa për luftën kundër radikalizimit

apo për çrrënjosjen e tij. Këto masa mund të kenë në fokus personat që ndodhen në rrezik potencial ose real, dhe/ose familjet e tyre. Në vetvete, masat mund të shërbejnë si mekanizma referimi pranë institucioneve përgjegjëse, ose mund të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çradikalizimin e këtyre personave.

OSHC-të mund të realizojnë në komunitetet e tyre programe ripërtëritëse kundër radikalizimit, duke ofruar faktorë të kundërt me ato që nxisin ekstremizmin, si dhe nëpërmjet lehtësimit të dialogut të personave më në rrezik me sektorin publik. Gjithashtu, OSHC-të mund të ndërhyjnë edhe duke lehtësuar integrimin dhe modelimin kulturor të komuniteteve në nevojë ose të atyre të rrezikuara, si dhe duke ofruar programe të munguara që mund të zbehin dhe të luftojnë radikalizimin. Këto programe mund të synojnë promovimin e vlerave dhe modeleve pozitive në tolerancën komunitare, të vlerave të demokracisë, kohezionin social, ofrimin e hapësirës së sigurt për të diskutuar ankesat dhe për t'i trajtuar ato në mënyrë konstruktive, duke sfiduar ideologjitë radikale dhe duke krijuar hapësirë të përshtatshme për dialog. Një nga potencialet më të mëdha të OSHC-ve, veçanërisht të atyre që veprojnë në nivel vendor, është fakti se ato punojnë ngushtë me qytetarët, duke komunikuar vazhdimisht ballë për ballë me ta, si dhe duke dëgjuar e adresuar ndjeshmëritë dhe problemet e tyre. Këto organizata kanë njohuri të mira, kanë besimin e komunitetit dhe kuptojnë rrënjët e konfliktit që nxit ekstremizmin¹⁵.

Kontributi i OSHC-ve në këtë fushë varet nga marrëdhëniet e tyre me institucionet, me komunitetin vendor, me organizatat e tjera në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, me burimet njerëzore dhe mbështetjen me fonde, me mjedisin e favorshëm të punës, nivelin e pavarësisë, potencialin për krijimin e rrjeteve vendore, besueshmërinë që kanë krijuar në komunitetin ku punojnë, por edhe në publik, si dhe me nevojën e vazhdueshme për të rritur kapacitetet e tyre në këtë fushë, e cila po zhvillohet me dinamizëm etj¹⁶.

Efektshmëria e OSHC-ve mund të vlerësohet në lidhje me aftësinë e saj për të ndërtuar dhe realizuar komunikim në nivel shumëplanësh. Komunikimi kërkon marrjen dhe dhënien e informacionit, si dhe kontribuon në krijimin e strategjive efikase të punës nga vetë OSHC-të në këtë fushë.

¹⁵ Aktiviteti global nga raporti i datës 26 qershor 2012, Trajtimi i ekstremizmit të dhunshëm në aktivitetin dytësor të rishikimit të strategjisë globale të Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit <http://www.humansecuritynetwork.net/documents/125374024/0/Report+of+the+June+26+Global+Conference+Addressing+Violent+Extremism>

¹⁶ Referuar edhe studimit për praktikën e mira, në bashkëpunim ndërmjet autoriteteve dhe shoqërisë civile, me qëllim parandalimin dhe reagimin ndaj radikalizimit të dhunshëm, një studim i komisionuar nga DG JLS e Komisionit Europian, korrik 2008 http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/doc_centre/terrorism/docs/ecvr_best_practice_core_report_en.pdf

6.1 Cilat janë modelet pozitive të ndërveprimit të shoqërisë civile? (shembuj nga vendet fqinje – arritjet e programit në Sanxhak)

Që prej vitit 2012, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi ka zbatuar disa aktivitete në Sanxhak, një rajon ky i Serbisë, si pjesë e Programit CVE¹⁷. Komiteti ka një përvojë të gjerë për sa i takon punës së bërë me grupet e të rinjve, veçanërisht në largimin e të rinjve nga ideologjitë dhe grupet nacionaliste të krahut të djathtë, përmes zhvillimit të mendimit kritik dhe promovimit të vlerave të të drejtave të njeriut.

Komiteti, zyra e të cilit ndodhet në kryeqytetin e Serbisë, bashkëpunon me OSHC-të lokale në Sanxhak dhe zbaton një sërë aktivitete të projektit. Legjitimiteti i organizatës do të vihej në diskutim nëse nuk do të kishte kapacitet për një bashkëpunim të tillë. Megjithatë, nga ana tjetër, OSHC-të lokale shpesh janë shënjestër e sulmeve nga grupet radikale, duke e bërë kështu të vështirë që ata të jenë zbatuesit e aktiviteteve dhe projekteve.

Synimi i kësaj nisme është fuqizimi i të rinjve, me qëllim parandalimin e radikalizimit dhe ndërtimin e besimit ndërmjet policisë e të rinjve, nëpërmjet 'thyerjes' së stereotipeve rreth policisë, islamit dhe kulturës rinore.

Konteksti në rajonin e Sanxhakut:

- Myslimanët përbëjnë shumicën e popullsisë.
- Popullatë e shkatërruar ekonomikisht, 50 % e popullsisë është e papunë.
- Mungesë investimesh dhe largësi e madhe nga autostrada.
- 50 % e popullsisë është më e re se 30 vjeç.
- Ka tensione të brendshme etnike.
- Divizionet e komunitetit mysliman.
- Krimet e pazgjidhura kundër boshnjakëve (myslimanëve) gjatë luftërave të viteve '90.
- Radikalizmi verbal ka shënuar rritje.
- Mungon besimi në institucionet shtetërore.

¹⁷ Ky projekt është zbatuar që prej vitit 2012, i mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit nëpërmjet programit "Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm".

a) Seminare dhe tryeza pune me të rinjtë:

Hartimi, përcjellja dhe publikimi i informacionit kundër ekstremizmit të dhunshëm është një detyrë e rëndësishme, por edhe sfiduese. “Ky informacion gjithëpërfshirës duhet të jetë në gjendje që të mbulojë dimensionet kryesore të ontologjisë ekstremiste të dhunshme, përkatësisht dimensionin politik, historik, socio-psikologjik, teologjik dhe instrumental”. Që kjo të realizohet në mënyrë të efektshme, duhet që zëdhënësi i lajmit të jetë i besueshëm. Zëdhënësit mund të jenë: studiues, klerikë fetarë të respektuar dhe të pavarur, ose aktivistë të OSHC-ve. Zëdhënësi bën diferencën.

Për shembull, një pjesëmarrës në një seminar tha se nuk do të përpiquej të bindte për të kundërtën një mik apo një kushëri, i cili vendoste të bëhej luftëtar i huaj. Ai nuk donte ta bindte atë që të mos vepronte ashtu, sepse ishte vendimi i tij dhe rruga e Perëndisë. *Përvoja jonë tregon se personat e besueshëm, që kanë njohuri për fenë, politikën dhe psikologjinë, duhet të flasin me individë të tillë. Po ashtu, është e rëndësishme që këto mesazhe të përshtaten për auditorë të ndryshëm, sidomos për të rinjtë.* Këto nuk duhet të jenë mesazhe banale propaganduese.

Cilat janë aktivitetet e realizuara në rajonin e Sanxhakut?

b) Aktivitete të realizuara nga të rinjtë:

Të rinjtë mund të organizojnë aktivitete për bashkëmoshatarët e tyre, ndërsa OSHC-të ofrojnë hapësira për dialog dhe mundësi për ndërtimin e urave lidhëse ndërmjet grupeve të polarizuara.

“Duke rritur ndërgjegjësimin ndaj teknikave jo të dhunshme të zgjidhjes së konflikteve dhe duke zhvilluar mundësi ndaj grupeve të ndryshme të të rinjve, me synimin që të punohet për qëllime të përbashkëta, programet e shoqërisë civile ndihmojnë në krijimin e bazave për shoqëri dhe liderë të ardhshëm më tolerantë. OSHC-të krijojnë edhe programe në media, të cilat prezantojnë modele të të rinjve dhe promovojnë bashkëjetesën ndërmjet grupeve etnike për mijëra shikues”¹.

c) Aktivizmi online:

Në përgjithësi mendohet se interneti është një instrument për rekrutimin e të rinjve. Megjithatë, numri i njerëzve që i shpallin haptazi veprimtaritë e tyre në Facebook, po zvogëlohet në raport me numrin real që shkojnë në luftë.

Aktivizimi online i aktivistëve të rinj në Sanxhak është i lidhur me veprimtaritë që ata organizojnë nëpërmjet internetit (kryesisht Facebook-ut), i cili përdoret

gjerësisht si një platformë njoftimi, me ftesa për ngjarjet që realizojnë dhe raporte të shkurtra për aktivitete që kanë realizuar.

Sfida: Në Sanxhak, shumë faqe interneti dhe rrjete sociale përdoren për sulme brutale ndaj kundërshtarëve politikë. Një ndër sfidat që lidhen me këtë është motivimi i të rinjve për të kundërshtuar përfshirjen në ekstremizmin e dhunshëm me anë të internetit. Një sfidë tjetër në qytetet e vogla është gjuha e urrejtjes dhe mesazhet negative, të cilat ushtrojnë shumë presion ndaj individëve, duke i larguar këta të fundit nga veprimtaritë kundër ekstremizmit të dhunshëm.

e) Përmirësimi i dialogut ndërmjet përfaqësuesve të të rinjve dhe policisë

Siguria e njerëzve kundrejt sigurisë së shtetit, ku më i rëndësishëm është fokusimi në mbrojtjen e qytetarëve sesa në numrin e terroristëve të kapur. Lidhur me këtë, është i domosdoshëm realizimi i një dialogu të hapur mes shoqërisë civile, policisë dhe autoriteteve, për të diskutuar dhe analizuar problemin e promovimit të ideologjive të dhunshme dhe të masave të nevojshme për t'i luftuar ato.

Besimi ndërmjet të rinjve dhe policisë po bëhet gjithnjë e më i fortë nga çdo bisedë e hapur që zhvillohet mes tyre. Kjo zvogëlon mundësinë për spekulime që shkaktojnë tensione të shtuara.

d) Mundësitë për punë dhe qëndrueshmëri të mëtijshme:

Hartimi dhe ndjekja e programeve arsimore të zhvilluara dhe agjendave të punësimit të të rinjve për të parandaluar ose larguar ata nga aktet e lidhura me ekstremizmin e dhunshëm.

OSHC-të kanë kontakt intensiv me komunitetin lokal, si rezultat i kësaj ne kemi një mundësi për të njohur së bashku problemet dhe për të vepruar në mënyrë parandaluese.

Përfshirja e OSHC-ve në hartimin e politikave dhe krijimi i programeve për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm është i rëndësishëm.

Krijimi i një rrjeti ekspertësh në Ballkanin Perëndimor, të cilët përqendrohen në temat relevante për këtë projekt dhe që kanë provuar se zotërojnë njohuri dhe përvojë në trajnimin e të rinjve për kundërshtimin e ideologjive ekstremiste.

Arritjet nga veprimtaritë e realizuara në rajonin e Sanxhakut:

Është krijuar një grup rinor, që punon për mobilizimin e aktivistëve kryesor të të rinjve.

- i) Të rinjtë e mobilizuar nga ky grup janë aktivë pas përfundimit të projektit.
- ii) Vërehen ndryshime të qëndrimeve (për shembull, një anëtar i grupit të të rinjve u transformua nga një tifoz futbolli, i cili ishte i pranishëm në incidente të lidhura me sportin, në një nga liderët e rinj në bashkësinë e tij lokale. Tani frymëzon të rinjtë e tjerë, duke sjellë kështu ndryshim.

Sfidat e një qasjeje të drejtpërdrejtë:

Sulmi ndaj Charlie Hebdo dhe vrasja e 12 gazetarëve (janar 2015) kërkonin një reagim të përshtatshëm nga të rinjtë në Sanxhak. U vendos që debati me temë “Feja nxit dialogun” të organizohej në Novi Pazar, një qytet me shumicë myslimane. Gjatë këtij debati, çështjet e diskutuara ishin si në vijim:

Ç’është islamizmi radikal? Kush po sulmohet, Europa apo myslimanët? Me kë hyn në dialog Charlie Hebdo? Cilat liri të karikaturës mbizotërojnë? Cilat janë arsyet e radikalizmit fetar dhe luftës për të?

Panelistët në këtë debat ishin ekspertë që e njohin terrenin, me përvojë akademike në çështjet e fesë, islamit, të drejtat dhe liritë e njeriut.

Pjesëmarrësit ishin qytetarë nga grupe të ndryshme shoqërore: të rinj, përfaqësues të komuniteteve myslimane, përfaqësues të policisë, zyrtarë të organeve të vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë kryetarin e bashkisë, partitë politike opozitare.

Konteksti, reziqet:

Që prej fillimit të projektit kjo ishte hera e parë që tema e ekstremizmit të dhunshëm diskutohej në mënyrë të drejtpërdrejtë.

OSHC-të organizatore u përballën me njëfarë rezistence ndaj idesë së organizimit të një debati publik në lidhje me këtë temë, të cilave ju komunikua se kjo ishte një temë shumë e ndjeshme dhe se mund të pritëshin reagime negative.

Situatën e vështirësonte më tej fakti se pas sulmeve ndaj Charlie Hebdo, në Novi Pazar u organizua një protestë për shkak të islamofobisë.

Në mënyrë që debati të ishte sa më i hapur dhe i fokusuar, ju dha kohë e nevojshme reagimeve të para ndaj kësaj ngjarjeje.

Debat i nxehtë:

Një grup pjesëmarrësish e lanë aktivitetin në shenjë proteste. Arsyet zyrtare të largimit ishin sepse nuk binin dakord me deklaratën e njërit prej panelistëve, i cili u shpreh se çdokush kishte të drejtë të kritikonte fenë dhe klerikët.

Po ashtu, ngjarjet dhe polemikat gjatë debatit shkaktuan shqetësim te organizatorët e rinj të aktivitetit. Ata ishin të shqetësuar se si do të perceptoheshin në bashkësinë lokale dhe nëse kjo do të ndikonte në sigurinë e tyre.

Menaxhimi i rrezikut:

Pas debatit, stafi me përvojë i komisionerit të lartë për të drejtat e njeriut foli gjerësisht me organizatorët e rinj. Ata treguan gatishmërinë për të kapërcyer frikën dhe paragjykimet e tyre.

Të rinjtë biseduan edhe me përfaqësuesit e policisë rreth Charlie Hebdo. Ata donin të dinin nëse sulmet terroriste në Europë mund të reflektoheshin në Novi Pazar dhe nëse kjo do të përkeqësonte nivelin e sigurisë apo ndjenjën e të qenit i sigurt.

7. PROCESI I RADIKALIZIMIT DHE SHENJAT PARALAJMËRUESE

7.1 Si identifikohen individët që janë të rrezikuar për t'u radikalizuar?

Në shoqërinë tonë, ndërsa radikalizimi dhe ekstremizmi po fitojnë vëmendje të vazhdueshme, është shumë e rëndësishme të identifikohen individët që janë të rrezikuar për t'u prekur nga këto fenomene. Radikalizmi rrezikon më së shumti grupet në nevojë, ku përfshihen fëmijët dhe të rinjtë, ata që e kanë përjetuar ekstremizmin dhe konfliktet e dhunshme, njerëz (gra e burra) që jetojnë në mjedis të varfër socio-ekonomik.

Po ashtu, nga radikalizmi mund të preken edhe fëmijët e të rinjtë që vijnë nga mjedise të ndryshme sociale, pasi, nisur edhe nga mosha, për ta është pikërisht koha kur formojnë identitetin, kërkojnë aventura, kërkojnë përgjigje në lidhje me besimin dhe përkatësinë, faktorë këto që e bëjnë këtë grup të hapur ndaj ndikimeve ekstremiste. Këto të fundit ofrojnë përgjigje, identitet dhe një rrjet të fortë lidhjesh sociale.

Gjithashtu, përdorimi strategjik dhe i përmirësuar i internetit apo i mediave sociale për të ndikuar te të rinjtë, i bën ata më të prekshëm se pjesën tjetër të popullsisë. Individët që jetojnë në zona, të cilat kanë pasur histori me ekstremizmin dhe konfliktet e dhunshme ndikohen nga grupet ekstremiste, pasi kjo kategori është shumë e prekshme dhe e ndjeshme ndaj radikalizimit apo rekrutimit në këto grupe. Po ashtu, njerëzit me të ardhura të ulëta dhe ata që jetojnë në mjedise të varfra e të pafavorizuara social-ekonomike janë më të prekshëm nga idetë radikale, madje shpesh etiketohen si objektiva "të lehtë".

Ekstremistët e rekrutuar janë kryesisht (por jo gjithmonë) meshkuj. Po ashtu, gratë dhe familjet janë gjithnjë e më shumë në shënjestër të rekrutuesve ekstremistë, disa prej të cilëve u drejtohen në mënyrë të veçantë femrave për kryerjen e akteve të dhunshme, duke synuar vendosjen e balancës gjinore në mbështetje të ekstremizmit.¹⁸

Identifikimi i individëve që rrezikohen nga grupet ekstremiste mund të jetë një proces jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe sfidues. Në këto kushte është e rëndësishme që të mos lejohet dëmtimi dhe cenimi i mëtejshëm i individëve në nevojë, tashmë duke i mbrojtur ata nga modelet e dëmshme të radikalizimit.

¹⁸ <https://www.publications.parliament.uk/pa/cm201012/cmselect/cmhaff/1446/144604.htm#note25>

7.2 Kush e nxit dhe e drejton radikalizmin (faktorët)?

Radikalizimi është një proces, jo një ngjarje e vetme. Ai është kompleks dhe dinamik. Nuk ka vetëm një mënyrë apo vetëm një individ të caktuar që preket nga radikalizmi. Prandaj, profilizimi në bazë të përkatësisë kombëtare, gjeografike, fetare, socio-ekonomike, të gjinisë, moshës ose të karakteristikave të tjera të thjeshta, vlerësohet se nuk është mjaftueshëm i qartë dhe i saktë.

Ka një numër faktorësh që ndikojnë në radikalizim. Këta faktorë, që mund të jenë tërheqës dhe nxitës, të brendshëm dhe të jashtëm, ndërveprojnë në mënyra nga më të ndryshmet, me pasojë radikalizmin. Ato kombinohen në mënyrë unike dhe rast pas rasti.

Një klasifikim më i gjerë i *nxitësve të ekstremizmit* është ai që dallon tre lloj faktorësh: nxitës, tërheqës dhe kontekstualë.

Faktorët nxitës i shtojnë individët drejt ekstremizmit dhe krijojnë kushte të favorshme për rritjen a përhapjen e thirrjeve për ekstremizëm të dhunshëm. Ekstremistët e dhunshëm shfrytëzojnë statusin dhe problematikat, me të cilat përballen individët. Faktorët nxitës janë socialë, ekonomikë, politikë dhe kulturorë. Ato ndikojnë në marginalizimin, cenimin e barazisë, diskriminimin, përjashtimin social, persekutimin, aksesin e kufizuar në arsim cilësor dhe në mundësinë për punësim; po ashtu edhe në mohimin e të drejtave dhe lirive, në çështjet e identitetit dhe të kulturës, në krijimin e konflikteve lokale, ekspozimin ndaj kontrollit të ashpër të qeverisë, veçanërisht torturës etj. Ndër këta faktorë, ankesat dhe problemet, me të cilat përballen këta individë janë burimi kryesor i radikalizmit. Në raste të tilla ata bëhen pre e lehtë e ekstremistëve.

Faktorët tërheqës ushqejnë thirrjet për ekstremizëm të dhunshëm. Këta faktorë mund të jenë shpërblime personale (të ardhura, punësim, premtime për aventura apo liri etj.), që u premtohen individëve kundrejt anëtarësimit në grupin e ekstremistëve, duke përdorur gënjeshtërën, mashtrimin, ligjërata bindëse apo ideologjike, si dhe taktika të tjera rekrutimi. Faktorët tërheqës nxiten në një terren ku shfrytëzohet statusi social i individëve, respekti nga kolegët, vetëvlerësimi, perspektiva për arritjen e lavdisë dhe famës, nevoja për fuqizimin personal, ndjenja të përkatësisë, marrëdhëniet personale, karizma dhe aftësitë për të tërhequr, nevoja për t'u përmbushur nga ana shpirtërore etj. Faktorët tërheqës janë po aq të rëndësishëm sa faktorët nxitës, sepse tërheqin individët në organizatat ekstremiste, i mbajnë dhe i radikalizojnë ata.

Faktorët kontekstualë ofrojnë një terren të favorshëm për shfaqjen e grupeve ekstremiste të dhunshme, shkaqet e të cilave lidhen me kontekstin dhe gjendjen në të cilën ndodhet vendi, si p.sh., kriminaliteti, mungesa e sigurisë, keqqeverisja, institucione të dobëta dhe të brishta, parajsat fiskale, regjime të diskreditura me opozitë të dobët ose inekzistente, prania e korrupsionit endemik dhe mosndëshkimi i zyrtarëve të lartë, financimi me baza shtetërore i grupeve ekstremistë etj.

Procesi i radikalizimit dhe rruga drejt ekstremizmit janë të ndryshme për secilin individ, por këto kategori faktorësh do të jenë gjithmonë të pranishëm. Një ndërveprim kompleks ndërmjet tyre shpjegon se si grupe të ndryshme të ekstremistëve kanë qenë në gjendje të depërtojnë në shoqëri dhe shtete të ndryshme, duke rekrutuar individë me prejardhje apo status të ndryshëm.

7.3 Si evoluojnë etapat e radikalizimit tek individët?

Ekzistojnë disa modele të procesit të radikalizimit¹⁹, të cilat përshkruajnë fazat se si një individ vulnerabël i shënjestruar për radikalizim shndërrohet në një individ aktiv, anëtar dhe kontribuues i grupeve ekstremiste. Midis këtyre modeleve, “Shkallët drejt terrorizmit”, nga Fathali M. Mogaddam²⁰, përshkruajnë evolucionin e individit drejt radikalizimit dhe në mënyrë të veçantë drejt terrorizmit të dhunshëm. Mogaddam shpjegon arsyet përse vetëm një pjesë e vogël e njerëzve që jetojnë në të njëjtat kushte përfundojnë duke u bërë terroristë të dhunshëm. Ky model përdor si metaforë një ndërtesë me pesë kate, që vjen duke u ngushtuar dhe ku të gjithë jetojnë në katin përdhes, por vetëm pak njerëz ngjiten në katin më të lartë (ekstrem).

Kati përdhes është vendi ku jetojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë. Në këtë kat të gjithë kanë perceptime relative për kufizimet, kërcënimet e identitetit dhe padrejtësitë, por do të qëndrojnë aty për sa kohë mendojnë se kushtet e tyre të jetesës janë të drejta. Por, nëse vërejnë padrejtësi, do të ngjiten në katin e parë.

Në katin e parë njerëzit shohin mundësitë që kanë për të ndryshuar trajtimin e padrejtë që mund t’u bëhet. Ata që gjejnë hapësira për të përmirësuar situatën e vet individuale dhe shohin mundësinë që të ndikojnë te vendimmarrësit e tyre, i lënë shkallët në këtë kat dhe ndjekin shtigje jo të dhunshme. Njerëzit e

¹⁹ http://www.safecampuscommunities.ac.uk/uploads/files/2016/08/yjb_preventing_violent_extremism_systematic_review_requires_uploading.pdf

²⁰ <http://fathalimoghaddam.com/wp-content/uploads/2013/10/1256627851.pdf>

pakënaqur, me mundësitë që kanë në dispozicion të ky kat, fillojnë të ndiejnë padrejtësinë nga paligjshmëritë e sistemit. Kështu ata fillojnë të 'kultivojnë dhunën', të fajësojnë të tjerët për problemet e tyre dhe ngjiten në katin e dytë.

Kati i dytë karakterizohet nga kultivimi i dhunës (agresioni i zhvendosur)²¹. Njerëzit që nuk kanë gjetur mënyrën për të përmirësuar gjendjen e tyre do të fillojnë të kërkojnë dikë për të fajësuar, si për shembull, qeverinë ose një palë të tretë, ndaj së cilës është zhvendosur agresioni, siç mund të jetë një pakicë etnike apo fetare. Njerëzit që janë të gatshëm për të ndërmarrë veprime të dhunshme fizike kundër 'fajtorëve (armikut)' dhe që aktivisht kërkojnë mundësi për ta bërë këtë, do të ngjiten në katin e tretë.

Në katin e tretë shfaqet ndikimi i organizatave terroriste. Njerëzit që ngjiten në këtë kat kanë treguar më parë gatishmëri ndaj dhunës dhe një moral që përputhet me terrorizmin. Këto ndjenja mund të theksohen nga një organizatë e dhunshme, e cila bën edhe trajnime apo ofron motivime morale. Me historitë e veta, ata i bindin të rekrutuarit se veprimet e dhunshme kundër një armiku të perceptuar janë të pranueshme dhe se qëllimi i tyre justifikon mjetet për arritjen e një 'shoqërie ideale'. Njerëzit që e ndiejnë se u përshtatet ky identitet i ri shoqëror, si anëtarë të një grupi të përzgjedhur, që synojnë të sjellin drejtësi në botë, do të ngjiten në katin e katërt.

Në katin e katërt, këta individë ndodhen në prag të hyrjes plotësisht në organizatën terroriste. Organizata promovon të menduarit "ne kundër atyre", forcon pozitat e saj, thekson izolimin nga miqtë, familja a shoqëria e gjerë dhe imponon fshehtësi strikte. Për njerëzit që ngjisin këtë kat është e vështirë t'i zbresin shkallët të gjallë, për shkak të presioneve për t'u pajtuar dhe për t'u bindur se duhen kryer akte terroriste, por edhe për shkak të mundësive gjithnjë e më të pakta për të lënë grupin. Nëse u jepet ndonjë mundësi, ata do të ngjiten në katin e pestë.

Kati i pestë është i fundit, ose faza operacionale. Këtu kryhen akte të dhunshme, ku individët mund të kalojnë të gjitha pengesat për vrasjen e njerëzve të pafajshëm. Organizata terroriste bën të mundur që të rekrutuarit të anashkalojnë mekanizmat natyrorë frenues, duke e kategorizuar objektivin si "armik", duke ekzagjeruar dallimet ndërmjet grupit të tyre dhe armikut potencial, si dhe duke parandaluar çdo akt frenues të viktimave të mundshme, që mund të ndryshojnë mendjen e individit "sulmues".

²¹ Agresioni i zhvendosur ndodh kur dikush nuk mund të reagojë ndaj burimit të nxitjes ose provokimit, kështu që në vend të burimit sillet në mënyrë agresive ndaj një personi tjetër, i cili nuk ka të bëjë fare me konfliktin fillestar.

Modeli Mogaddam tregon se politikat e shpeshta afatshkurtra, që synojnë vetëm identifikimin dhe ndalimin e terroristëve potencialë, nuk janë efektive, pasi ato thjesht do të krijojnë hapësirën që të zëvendësohen me persona të rinj në pozita të dobëta. Këto politika duhet të zëvendësohen me ndërhyrje afatgjata, të cilat të synojnë adresimin e problemeve themelore. Si rezultat, duhet të përmirësohet gjendja në katin përdhes, në mënyrë që të mos perceptohet më si i padrejtë dhe i pashpresë nga një pjesë e madhe e shoqërisë. Kjo do të minimizojë iniciativat e individëve të këtij kati për t'u ngjitur në katet më lart dhe për t'u bashkuar me organizatat terroriste.

7.4 Cilat janë shenjat e hershme paralajmëruese të radikalizimit dhe ekstremizmit?

Radikalizimi është një proces që mund të ndodhë shpejt, por mund të kërkojë edhe një kohë të gjatë. Duke qenë i tillë, krijohen mundësi për identifikimin e hershëm të rreziqeve dhe gjetjen e zgjidhjes më të përshtatshme për të mbrojtur dhe larguar njerëzit nga ky fenomen.

Nëse dëshironi të punoni në komunitetin tuaj për të adresuar radikalizimin dhe ekstremizmin, ose thjesht jeni të shqetësuar se dikush që njihni mund të tërhiqet nga ndonjë grup radikal, ju mund të evidentoni disa prej shenjave paralajmëruese, të cilat të kombinuara, janë identifikuar si shenja të radikalizimit të mundshëm:

- Luhatje temperamentit, humbje e interesit në mënyrë të papritur dhe drastike, si dhe distancim nga aktivitetet e mëparshme, familja apo miqtë;
- Krijimi i miqësive të reja, që fshehin identitetin e tyre dhe ndikojnë negativisht mbi të;
- Luhatje në karakter, ndryshime të papritura dhe drastike në pamje ose në veshje;
- Ndryshime të përgjithshme në humor, gjendje shpirtërore dhe sjellje të luhatura lidhur me ushqimin, gjuhën ose financat (duke kursyer apo duke shpenzuar para në mënyrë të papritur);
- Ndryshimet në sferën sociale, komente antisociale, refuzim të autoritetit, refuzim për të bashkëvepruar në mënyrë shoqërore, tërheqje dhe izolim;
- Të folurit në mënyrë të përçarë 'ata dhe ne', apo me terma përcmues ndaj të tjerëve që janë të ndryshëm, duke refuzuar të merren me ta ose duke abuzuar ndaj tyre;

- Shprehja e pikëpamjeve radikale apo mbështetja e pikëpamjeve të tilla, duke justifikuar veprimet e radikalistëve, duke mbështetur mesazhe ekstremiste, akte apo mjete të dhunshme;
- Rritja e ndjeshmërisë ndaj teorive apokaliptike e konspirative dhe ndjenjave të persekutimit;
- Interesimi i papritur për politikën e brendshme ose të jashtme, duke shfaqur mosbesim dhe irritim ndaj politikëbërësve;
- Përdorimi i literaturës dhe imazheve ekstremiste;
- Vendosja e kontakteve me rekrutuesit ekstremistë, duke u bashkuar ose duke u përpjekur për t'u bashkuar me organizatat ekstremiste;
- Përpjekje për të rekrutuar të tjerë në ideologji ekstremiste;
- Përgatitje për të thënë lamtumirë;
- Të qenët i fshehtë dhe ngurrues për të diskutuar aktivitetet, vendndodhjen, bashkëpunëtorët;
- Kalimi i kohës së tepërt në internet ose në telefon, duke ndryshuar identitetin online, duke zotëruar telefona celularë ose pajisje të ngjashme dhe duke i mbajtur ato private në mënyrë strikte.

Kjo listë shenjash paralajmëruese nuk është shteruese dhe rrjedhimisht nuk garanton një vlerësim të besueshëm të rreziqeve. Megjithatë, këto janë shenja të mundshme të radikalizmit, të cilat mund të ndihmojnë për t'u orientuar se ku duhet të ketë vëmendje dhe ku duhet të mblidhen informacione të mëtejshme.

Gjithashtu, këto nuk janë shenja përfundimtare të radikalizimit apo të varësisë ndaj tij. Ndonjëherë shenjat paralajmëruese janë të qarta dhe në raste të tjera më pak të dukshme, veçanërisht nëse grupi radikal u kërkon fshehtësi anëtarëve të tij. Praktikisht, të gjitha këto shenja, sidomos nëse vlerësohen veç e veç, mund të shkaktohen nga shumë faktorë dhe jo domosdoshmërisht nga radikalizmi. Këtu futen sfidat ose krizat që mund të kalojnë njerëzit në jetë, faza e zhvillimit (sidomos të rinjtë), abuzimi me drogën apo alkoolin etj. Prandaj është shumë e rëndësishme të mos tregohet në reagimet ndaj personave që shfaqin shenja të tilla, me qëllim që të mos shkaktohet stigmatizim, dobësim i mëtejshëm dhe viktimizim i tyre.

8. ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

8.1 Cili duhet të jetë roli i organeve ligjzbatuese?

Roli që kanë institucionet përgjegjëse për rendin dhe sigurinë në zgjidhjen e problemeve të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është vlerësuar tradicionalisht si represiv. Këto institucione nuk e përdorin kryesisht parandalimin, i cili është i reduktuar dhe në funksion të represionit. Te masat represive përfshihen ato që kanë të bëjnë me gjurmimin, identifikimin, arrestimin dhe ndjekjen penale të personave të dyshuar si autorë të akteve terroriste apo të krimeve me bazë urrejtjen, ose ata të cilët kanë marrë pjesë apo kanë organizuar pjesëmarrjen e të tjerëve në konflikt të armatosur në një vend të huaj.

Masat parandaluese mund të jenë të larmishme. Për shembull, gjykatat mund të kontribuojnë në parandalim duke aplikuar masa alternative dhe sanksione, përmes të cilave të akuzuarit dërgohen për të kryer punë të dobishme sociale apo humanitare, ose i nënshtrohen trajtimit psikosocial dhe shëndetësor. Logjika e zbatimit të masave alternative mbështetet në faktin se ato do të kenë efekt më të madh në ndryshimin dhe korrigjimin e sjelljes së individit krahasuar me dënimet me burg.²²

Rezultatet e masave parandaluese është vështirë të maten dhe duhet shumë kohë që të bëhen të dukshme. Prandaj, shtete të caktuara, të cilat janë përballur me rritjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmin, kanë shtuar masat represive,²³ kurse parandalimi është kufizuar në anashkalimin e rrezikut të drejtpërdrejtë për sigurinë dhe zbatimin e masave administrative. Në vend që të fokusohen tek individët, shërbimet e sigurimit dhe policia ngrenë dyshime për përkrahje të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit nga të gjitha komunitetet myslimane apo nga një pjesë e tyre. Kjo qasje ka pasur si rezultat izolimin e komuniteteve “të dyshuara” dhe rritjen e mosbesimit të tyre ndaj organeve të rendit. Në qendër të vëmendjes së shërbimeve të sigurisë dhe organeve të sistemit të drejtësisë penale nuk duhet të jenë komunitetet, por ekskluzivisht individët e dyshuar për ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm.

²² Për informacione më të hollësishme mbi masat alternative, shih: Specific recommendations regarding the implementation of alternative measures, Lifecycle Toolkit, Global Counterterrorism Forum, <https://goo.gl/KXBoUD>.

²³ Shembull drastik të masave represive paraqet Franca, e cila pas sulmeve terroriste të janarit të vitit 2015 ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme dhe ka urdhëruar patrullimin e 10 000 ushtarëve në të gjithë vendin. Mirëpo, hetimi i parlamentit francez ka vërtetuar që efikasiteti i këtyre masave është shumë i dyshimtë. Përpos kësaj, ato masa edhe janë zgjatuar. France needs intelligence overhaul after attacks: inquiry, The Local, 5.7.2016. <https://goo.gl/KQDvtN>

8.2 Cili është roli i OSHC-ve në raport me punën e institucioneve ligjzbatuese?

OSHC-të mund të mbikëqyrin proceset hetimore dhe gjyqësore të individëve të akuzuar për ekstremizëm të dhunshëm ose terrorizëm, si dhe të advokojnë për zbatimin e masave alternative ndaj tyre. Gjithashtu, OSHC-të mund të monitorojnë dhe analizojnë, nëpërmjet studimeve apo hulumtimeve, se cili ka qenë fokusi i organeve ligjzbatuese dhe nëse individët janë të dyshuar për ekstremizëm apo për terrorizëm. Në analizë mund të merren edhe masat parandaluese, për të parë se cilat janë ato, a janë të larmishme dhe nëse u përgjigjen dinamikave apo përhapjes së ekstremizmit dhe terrorizmit; po ashtu, nëse ato janë efektive dhe produkt i veprimtarisë së koordinuar mes institucioneve që duhet të bashkërendojnë punën e tyre në këtë drejtim. Një mundësi e shkëlqyer e OSHC-ve për të ndarë me aktorët e tjerë njohuritë dhe përvojat që kanë në këtë fushë janë konferencat dhe seminarët, nëpërmjet të cilave këta aktorë mund të nxiten për të pasur mënyrë tjetër të të menduarit mbi këtë tematikë. OSHC-të mund të analizojnë faktorët kryesorë të ekstremizmit të dhunshëm dhe në bazë të rezultateve hulumtuese mund të rekomandojnë masa parandaluese relevante dhe efektive ndaj institucioneve ligjzbatuese.

8.3 Sa i rëndësishëm është policimi në komunitet, si mjet i kthimit të besimit te policia?

Policimi në komunitet është kthyer në një mekanizëm të rëndësishëm i përmirësimit të efikasitetit të punës së policisë. Kjo qasje nënkupton forcimin e lidhjeve të këputura dhe besimit të humbur midis komunitetit lokal dhe policisë, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë dhe rezistencën e komunitetit kundrejt sfidave apo kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë. Policia përpaket që, së bashku me shumë aktorë të tjerë, të identifikojë dhe të zgjidhë problemet më të rëndësishme të komunitetit lokal, të cilat nuk duhet të jenë domosdoshmërisht të lidhura me sigurinë (p.sh., cilësia e keqe e infrastrukturës, mungesa e programeve apo aktiviteteve kulturore për të rinjtë), por zgjidhja e tyre mund të jetë e rëndësishme në krijimin e besimit dhe zgjerimin e sfidave apo të kërcënimeve për sigurinë.

Është vlerësuar si e domosdoshme që policia të jetë vazhdimisht e pranishme në komunitetin lokal dhe jo vetëm të reagojë në bazë të thirrjeve apo kur ndodh ndonjë incident. Kjo nënkupton që policia duhet të dërgojë punonjës të policisë vendore në terren, për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me banorët e zonës dhe për t'i ndihmuar ata në zgjidhjen e problemeve të tyre. Një praktikë pozitive është që policia në komunitet të identifikojë dhe të marrë në konsideratë

përbërjen e popullsisë lokale. Është me rëndësi që brenda strukturës së policisë, në aspektin organizativ, policimi në komunitet të ndahet, në mënyrë që të ketë pavarësi më të madhe në raport me strukturat e tjera tradicionale të policisë.²⁴

Çfarë duhet të marrë në konsideratë policimi në komunitet?

Policimi në komunitet nuk duhet të përdoret si maskë e policisë për marrjen në mënyrë sekrete të të dhënave në komunitet dhe për zgjerimin e rrejtës së saj të informuesve. Nëse policët e angazhuar në komunitet zbatojnë metoda të vjetra të punës, përmes të cilave demonstron forca dhe sjellja arrogante, kjo përbën një veprim të papërshtatshëm dhe të rrezikshëm.

Policia duhet të tregojë se është e sigurtë në dëshirën për të zgjidhur probleme, të cilat qytetarët i konsiderojnë të rëndësishme. Policia nuk duhet t'i imponojë çështje apo t'i shkaktojë probleme komunitetit lokal, por duhet të dëgjojë se cilat janë problemet e rëndësishme për të. Përvoja e shteteve me traditë më të gjatë ka treguar se policimi në komunitet duhet të jetë në funksion të identifikimit të individëve dhe zgjidhjes së problemeve që i çojnë ata në ekstremizëm të dhunshëm. Ndërkohë, identifikimi i individëve të përfshirë në ekstremizëm, me qëllim mbikëqyrjen dhe ndjekjen penale të tyre, është detyrë e sektorëve të policisë të ngarkuar me sigurimin dhe ndjekjen e krimeve, jo detyrë e policisë në komunitet.

Policia në komunitet mund të identifikojë personat në rrezik nga radikalizimi, por këtu bëhet fjalë për persona në fazën e hershme të radikalizimit, të cilët nuk e pranojnë ende dhunën si formë legjitime në zgjerimin dhe mbrojtjen e bindjeve të tyre. Në këtë fazë, policia nuk i vë këta persona nën mbikëqyrje dhe masa policore, por përpiqet që së bashku me aktorët lokalë, si shkolla, familja, shoqëria etj., të parandalojë radikalizimin e mëtejshëm të tyre.²⁵

²⁴ Për informacione më të hollësishme mbi rolin e policisë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm shih: Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Community-Policing Approach, OSCE, Vienna, 2014.

²⁵ Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, misionet e OSBE-së kanë përkrahur paraqitjen dhe zbatimin e konceptit të policisë në komunitet.

8.4 Cili është roli i OSHC-ve lidhur me policimin në komunitet?

OSHC-të mund të organizojnë fushata ndërgjegjësimi me qytetarët, për t'u shpjeguar se ç'është policimi në komunitet, cilat janë dobitë e tij dhe se si mund të përfitojnë ata. OSHC-të mund të ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre pozitive për policimin në komunitet në vendet tjera, por edhe në vendin e tyre, në bashki dhe në qytete të ndryshme. OSHC-të mund të jenë edhe ndërmjetësuese apo të organizojnë konsultime ndërmjet qytetarëve dhe policisë, me qëllim nxitjen dhe forcimin e policimit në komunitet.

OSHC-të mund të jenë promotore të hartimit dhe përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore, të strategjive apo planeve të veprimit për policimin në komunitet, si dhe mund të bëjnë komente dhe sugjerime profesionale, kur këto akte hartohen me nismë të vetë institucioneve. Gjithashtu, OSHC-të mund të monitorojnë zbatimin e kornizës ligjore të policimit në komunitet, të zhvillojnë sondazhe me qytetarët për të matur ndjeshmërinë dhe vlerësimet e tyre mbi këtë policim dhe të llobojnë e advokojnë me institucionet shtetërore, me qëllim marrjen e masave që synojnë adresimin e problematikave të identifikuara.

8.5 Ç'janë këshillat lokalë të sigurisë dhe përse janë të nevojshme?

Përgjigjja e koordinuar dhe e integruar e komunitetit lokal ndaj problemeve të sigurisë

Këshillat lokalë të sigurisë (KLS) krijohen nga pushteti vendor, me qëllim koordinimin e formave të reagimit të aktorëve lokalë ndaj probleme të sigurisë që ekzistojnë në komunitet.²⁶ Përbërja e këshillave të sigurisë nuk është e njëjtë në të gjitha bashkitë dhe qytetet. Ndryshime hasen në elemente të tilla si: numri i anëtarëve, funksioni i tyre etj. E rëndësishme është që kjo përbërje të jetë e tillë që të mundësojë identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve.

Gjithashtu, është e domosdoshme që në përbërje të këshillave të jenë përfaqësuesit e institucioneve më të rëndësishme në nivel vendor, të cilat mbulojnë hallkat kryesore të zinxhirit që lidhet me çështjet e sigurisë, si për shembull, kryetari i bashkisë, drejtuesi i policisë në nivel vendor, përfaqësuesit e organeve bashkiake, të gjykatës, prokurorisë, të shërbimeve sociale dhe shëndetësore etj. Bërja pjesë e aktorëve joshtetërorë në këto këshilla ka rëndësi

²⁶ "KLS-të janë krijuar në të gjitha komunat e Kosovës dhe në gjysmën e komunave në Serbi, ndërsa në Shqipëri këto organe janë krijuar në tri bashki: Elbasan (dhjetor 2016), Librazhd (mars 2017) dhe Cërrik (prill 2017)."

në drejtim të forcimit të pjesëmarrjes, transparencës dhe konsultimit, si për shembull, me përfaqësues të shoqërisë civile, të mediave, intelektualëve dhe akademikëve, biznesit, profesionistëve të lirë në çështjet e sigurisë, si dhe me përfaqësuesit e komunitetit lokal, të cilët reflektojnë përbërjen etnike dhe fetare të komunitetit. Praktika tregon që këshillat për siguri në bashki dhe qytetet të ndryshme kanë zakonisht nga 10 deri në 15 anëtarë. KLS-ja mund të jetë një mekanizëm që promovon dhe nxit zbatimin e koordinuar dhe efikas të policimit në komunitet.

Këshilli analizon gjendjen sigurisë në komunitetin lokal, në bazë të së cilës harton strategjinë e sigurisë lokale dhe planin e veprimit për zbatimin e saj²⁷. Realizimi i këtyre detyrave bazë nga këshilli duhet të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, duke organizuar konsulta e dëgjesa me një rreth sa më të gjerë aktorësh nga komuniteti lokal, apo edhe sondazhe të drejtpërdrejta me komunitetin. Gjithashtu, këshilli duhet të formojë grupe të posaçme pune, të cilat janë përgjegjëse për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të veçantë për komunitetin lokal.

Cilat janë dobësitë e vërejtura në punën e këshillave dhe si mund të kapërcehen ato?

Praktika e deritanishme e punës së këshillave ka treguar që mbështetja politike është e domosdoshme për të pasur sukses në punën e tyre. Megjithatë, nuk është e dobishme që punët operative të kryhen nga politikanët në nivel vendor, por do të ishte e rekomandueshme që këshillat të kenë koordinatorë, të cilët të përkushtohen dhe të angazhohen në përmbushjen e detyrave nga këshilli. Gjithashtu, nuk është mirë që politikanët ta shfrytëzojnë këshillin për diskutime politike apo ballafaqim me opozitën, as të përpiqen të marrin nga përfaqësuesit e policisë në këshill informacione për partitë/politikanët opozitarë. Politizimi i këshillave mund të çojë edhe deri te ndërprerja e vazhdimësisë së punës së tyre.²⁸ Prandaj është shumë e rëndësishme që të gjithë anëtarët e këshillit të gëzojnë mundësi të barabarta në raport me njëri-tjetrin, pavarësisht nga statusi i tyre apo nëse përfaqësojnë sektorin publik apo atë privat.

²⁷ Qyteti i Pazarit të Ri në jug të Serbisë ka aprovuar strategjinë e sigurisë së qytetit të Pazarit të Ri për periudhën 2016-2020, në të cilën nuk është theksuar në mënyrë eksplicite problemi i ekstremizmit të dhunshëm, edhe pse sipas vlerësimeve, 30 persona nga kjo zonë kanë shkuar në Siri dhe Irak. Megjithatë, përmes strategjisë janë identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në radikalizimin e individit, posaçërisht të të rinjve dhe janë propozuar masat për largimin e tyre. Kjo qasje e kujdesshme është pranuar që të mos krijohet stigmë për një pjesë të komunitetit. <http://www.novipazar.rs/en/dokument>

²⁸ Saša Đorđević i Gorana Radovanovic, Partnership for Safe Communities in Serbia, BCSP, Belgrade, 2014.

Transparenca ndaj publikut, si dhe konsultimi e gjithëpërfshirja e komunitetit lokal dhe e grupeve të interesit është një mënyrë për të kapërcyer vështirësitë që këshillat mund të kenë në punën e tyre.

8.6 Cili është roli i OSHC-ve në raport me këshillat lokale të sigurisë?

OSHC-të mund të luajnë rol të rëndësishëm në identifikimin dhe analizën e nevojave a të problemeve të komunitetit lokal, duke ia adresuar këto këshillat. Gjatë hartimit të strategjive dhe planeve të veprimit të sigurisë lokale, OSHC-të mund të kontribuojnë me sugjerime dhe mendime profesionale, ose mund të advokojnë për përmirësimin e tyre, nëse ato janë hartuar tashmë. OSHC-të mund të jenë edhe përçues të përvojave pozitive të punës dhe të modeleve të këshillave në qytete, bashki apo vende të tjera, por dhe të shërbejnë si ndërmjetës për rrjetëzimin e këshillave dhe forcimin e bashkëpunimit mes tyre.

8.7 Ç'është mekanizmi referues dhe përse është i rëndësishëm?

Zbulimi i hershëm dhe parandalimi i radikalizimit tek individ

Në vendet e Europës Perëndimore (për shembull, në Danimarkë, Britaninë e Madhe, Austri), përgjigja e komunitetit lokal ndaj sfidës së ekstremizmit të dhunshëm paraqitet përmes krijimit të **mekanizmit referues**. Mekanizmi referues nuk është organ i posaçëm, por përbëhet nga një sërë rregullash dhe procedurash që përcaktojnë konkretisht rolin e institucioneve vendore në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Mekanizmi shërben për zbulimin e hershëm të shenjave të radikalizimit tek individ, për përcaktimin e shkaktarëve të tij, si dhe mundëson hartimin dhe ofrimin e një pakete shërbimesh për individin, me qëllim parandalimin e radikalizimit të mëtejshëm të tij. Ofrimi i shërbimeve varet rast pas rasti, bazuar te shkaktarët që kanë çuar në radikalizim. Këto shërbime mund të përfshijnë këshillim me drejtuesit e komuniteteve fetare, punonjësit socialë dhe psikologët, përfshirjen e personit në aktivitete sportive, sociale, kulturore etj. Për llojin, natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit vendosin trupa kolektive, të cilët përbëhen nga anëtarë me funksione të ndryshme, si përfaqësues të institucioneve arsimore, sociale, shëndetësore dhe fetare, OSHC-të, si edhe përfaqësues të policisë e të gjyqësorit.

Të gjitha rastet ndiqen individualisht, por mund të ndiqen edhe në grup. Rastet e radikalizimit të personave mund t'i raportojë çdokush që i vëren ato, por këtu bëhet fjalë kryesisht për anëtarët e familjes, miqtë dhe mësuesit në institucionet arsimore, pasi ata kalojnë shumë kohë me të rinjtë, të cilët janë edhe grupi më i prekur. Rrjedhimisht, puna me familjen, me shoqërinë dhe me shkollën është e një rëndësie të veçantë, sepse këto nuk duhet thjesht ta njohin mekanizmin, por edhe të kenë besim e siguri për ta referuar rastin. Për siguri, mekanizmi referues mund të jetë i pavarur nga këshillat lokalë, por mund të jetë edhe pjesë përbërëse e tij, çka parandalon mbivendosjet e ndërhyrjeve dhe krijimin e strukturave paralele.

Çfarë duhet shmangur nga mekanizmi referues?

Mekanizmi referues duhet të përdoret me kujdes, sepse në të kundërt mund të kthehet në mekanizëm për “gjueti shtrigash” dhe të krijojë efekte të kundërta nga qëllimi i krijimit.²⁹ Prandaj është me rëndësi që shenjat e para të radikalizimit të analizohen fillimisht për një periudhë të caktuar kohore, për të përcaktuar nëse ato përsëriten dhe shumëfishohen. Po ashtu, është e rëndësishme që të bëhet edhe dallimi ndërmjet dikujt që shtyhet kureshtia të interesohet për përmbajtje ekstremiste, prej dikujt që beson realisht në to. Mekanizmi referues nuk është krijuar për të hetuar dhe denoncuar ekstremistët e dhunshëm apo terroristët, sepse kjo është detyrë e organeve të policisë dhe ndjekjes penale. Mekanizmi referues i shërben parandalimit të hershëm, pra, parandalon dikë, i cili ka filluar të besojë në përmbajtje ekstremiste, që të bëhet i dhunshëm dhe terrorist, apo të përfundojë në ndonjërin prej fronteve të luftës jashtë vendit.³⁰

8.8 Cili është roli i OSHC-ve në raport me mekanizmin referues?

Në disa shtete, OSHC-të kanë luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e mekanizmave referues, duke nxitur, promovuar ose kontribuar në krijimin e tyre. Gjithashtu, OSHC-të mund të organizojnë edhe trajnime për përdoruesit e mekanizmit referues, për shembull, se si të dallojnë shenjat e hershme të radikalizimit, të mbikëqyrin efikasitetin e zbatimit të tij dhe nëse ka qenë ose jo

²⁹ Në Britaninë e Madhe është shënuar një rast, kur stafi i një kopshti fëmijësh ka regjistruar një fëmijë katërvjeçar në programin e çradikalizimit. Ben Quinn, Nursery ‘raised fears of radicalisation over boy’s cucumber drawing’, The Guardian, 11.3.2016. <https://goo.gl/ieeEqs>

³⁰ Modeli danez i mekanizmit referues konsiderohet njëri nga modelet më të suksesshme në botë. Ai është krijuar sipas *Channel model* nga Britania e Madhe, me thujtë të njëjtat elemente e strukturë. Mënyra e përdorimit të mekanizmit është e ndryshme dhe ka rezultate më të mira. Për informacione më të hollësishme mbi modelin danez shih: Ann-Sophie Hemmingsen, An Introduction to the Danish Approach to Countering and Preventing Extremism and Radicalization, DIIS, Copenhagen, 2015.

i suksesshëm. Ato mund të analizojnë rastet e referuara të mekanizmit, si janë adresuar ato, cilat shërbime janë ofruar, nëse kanë ndikuar në parandalimin e ekstremizmit etj. Në faza të ndryshme të mekanizmit referues, OSHC-të, sikurse është përmendur edhe më sipër, mund të jenë pjesë e rregullave dhe procedurave të tij, duke dhënë një kontribut profesional dhe të orientuar drejt cilësisë.

